





Rexhep Qasja

Dëshmitar  
në kohë historike

Ditari

**Ditari i REXHEP QOSJES  
DËSHMITAR NË KOHË HISTORIKE  
do të ketë nëntë vëllime,  
që përmbledhin këto vite:**

- 1. Vëllimi i parë 1966-1974**
- 2. Vëllimi i dytë 1975-1978**
- 3. Vëllimi i tretë 1979-1981**
- 4. Vëllimi i katërt 1982-1983**
- 5. Vëllimi i pestë 1984-1985**
- 6. Vëllimi i gjashtë 1986-1989**
- 7. Vëllimi i shtatë 1990-1998**
- 8. Vëllimi i tetë 1999-2007**
- 9. Vëllimi i nëntë 2008-2015**

REXHEP QOSJA  
**DËSHMITAR NË KOHË HISTORIKE**

Koha e protektoratit  
(1999-2001)

---

BOTIMET TOENA



REXHEP QOSJA

DËSHMITAR  
NË KOHË  
HISTORIKE

*Koha e protektoratit*

(1999-2001)

**Libri i tetë**

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Kopertina dhe përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-38-1

© Shtëpia Botuese Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollështa", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)



# 1999

## 26.6.1999

E shtunë.

E shtuna premton shtim e përparim. Por, mund të ndodhë edhe e kundërta. Varet kush është, ç'mendje e ç'moral ka shtunaku.

Regjimi pushtues i Serbisë dhe i Malit të Zi ka pësuar disfatë në Kosovë dhe është dëbuar prej kolonisë së vet gati njëqindvjeçare.

Kosova është shpallur protektorat ndërkombëtar: protektorat ndërkombëtar administrativ dhe ushtarak.

Është caktuar edhe i dërguari i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në këtë protektorat dhe ky është braziliani Serxho de Mello.

Mbahet mbledhja e parë e këtij protektorati, të cilën e kryeson Ai, i dërguari i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, braziliani, Serxho de Mello.

Mbledhja filloi në orën 11:00.

Në këtë mbledhje janë ftuar përfaqësuesit e subjekteve politike dhe të organizatave të pavarura: Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Mehmet Hajrizi, Rexhep Qosja, Iljaz Kurteshi, Edita Tahiri, Veton Surroi dhe Blerim Shala, me përjashtim të Iljaz Kurteshit, të gjithë pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje.

Në fillim të mbledhjes, Serxho de Mello me bashkëpunëtorët e tij na e shpjegojnë përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të protektoratit ndërkombëtar. Posa e kryejnë fjalën e tyre shpjeguese, përfaqësuesja e Lidhjes Demokratike të Kosovës në këtë mbledhje, Edita Tahiri, hapi kreun e polemikave rreth “pushtetit tonë”, të neve shqiptarëve, në këtë protektorat administrativ dhe ushtarak.

Nuk e kisha perceptuar kurrë, as në Rambuje, as më parë, ashtu polemiste dhe ashtu të paqartëpamje, këtë grua politikane.

Iu përgjigj Mehmet Hajrizi: me maturi politike.

Mbas Mehmet Hajrizit fjalën e mori Iljaz Kurteshi dhe e mori për të përkrahur fjalët e Edita Tahirit për “pushtetin tonë” nën dhunën dhe terrorin e Millosheviqit, që ai, si as ajo, s’ë përmendi fare! Dhe, si ta përmendte? Po ai me Fehmi Aganin e me Ibrahim Rugovën, në të vërtetë ishin asistentë të atij pushteti të Millosheviqit në Kosovë!

Mbas Iljaz Kurteshit fjalën e mori Jakup Krasniqi, i cili, si Mehmet Hajrizi, e kundërshtoi paraqitjen “institucionale” të Edita Tahirit e, mandej, edhe të Iljaz Kurteshit.

Mbas Jakup Krasniqit fjalën e mori prapë Edita Tahiri; mbas Edita Tahirit fjalën e mori prapë Mehmet Hajrizi; mbas Mehmet Hajrizit fjalën e mori prapë Iljaz Kurteshi; mbas Iljaz Kurteshit fjalën e mori prapë Jakup Krasniqi: mbas tij prapë Edita, mbas Edita Tahirit prapë Mehmeti, mbas Mehmetit prapë Iljazi, mbas Iljazit prapë Jakupi!

U krijua atmosferë e rëndë retorike e politike.

Mbi mbledhjen ranë re e mjegull!

Dhe, kështu, në mbledhjen e parë të Kosovës protektorat, protektorat i OKB-së, protektorat administrativ e ushtarak, ne u treguam çka ishim: të papjekur politikisht, palejueshëm të ndjenjësuar.

U ndjeva keq.

Mendoj: çka do t’u thonë tani për ne eprorëve ndërkombëtarë braziliani De Mello dhe evropianët e pranishëm në mbledhje!

Kosovën do ta pushtetojnë përfaqësuesit e OKB-së, do ta pushtetojnë administrativisht dhe ushtarakisht, kurse ne grindemi për karrige! Edita dhe Iljazi, edhe tani, nën De Mellon, duan ta “qeverisin” Kosovën si nën Millosheviqin, duke mbledhur tre përqindëshin, duke zhvatur shumë nga djersët e gasterbajtsëve tanë në botë, duke bredhur poshtë e lart në vetura luksoze e në aeroplanë e duke u rrethuar me servilë e privilegje të ndryshme!

Ndasitë partiake, të nxitura prej udhëheqjes së LDK-së, edhe në këto kushte, e shquajnë mentalitetin tonë të patejkaluar fisnor, mendjen tonë të kufizuar fisnore!

U pa qartë se Edita Tahiri dhe Iljaz Kurteshi kishin ardhur me detyrë të caktuar prej të parëve të LDK-së, që të shquajnë rolin e “institucioneve” të tyre të paqena, në njërën anë, kurse rëndësinë e “zgjedhjeve të lira e demokratike” nën dhunën e terrorin e regjimit të Millosheviqit, në anën tjetër, e kjo do të thoshte se kishin ardhur të porositur që të shkaktojnë konflikt duke e shpallur të paligjshme Qeverinë e Përkohshme, në krye me Hashim Thaçin, të krijuar njëzëshëm në Rambuje.

Hashim Thaçi, ndërkaq, nuk e quajti aspak të nevojshme të merrej me pykat e kalbura politike të Editës dhe të Iljazit: ua la këtë punë Mehmetit dhe Jakupit. Në diskutimin e tij, prandaj, ai tha disa fjalë të mekura për disa nga çështjet me të cilat u morën De Mello dhe bashkëpunëtorët e tij, njëra prej të cilave ishte çështja e serbëve të Kosovës. Dhe foli për këtë çështje siç s’do të duhej, në të vërtetë foli ashtu siç e kishte çmuar se iu pëlqente ndërkombëtarëve!

Mendova: do të ngrihet shumë e shpejt Hashimi ynë në hierarkinë kosovare të protektoratit dhe të mbas protektoratit! Ka mësuar, po shihet, se para kujt, kur e si duhet të ulet koka!

Po mirë: më mirë Hashimi se ndonjë tjetër; më mirë Hashimi se Ibrahimimi, i cili është i mësuar prej Lidhjes Komuniste ose të heshtë, ose, kur të flasë, të flasë kryepërtokas!

## **27.6.1999**

Jam zgjuar me dhembje të padurueshme në mjedis dhe, në përgjithësi, në kurriz, besoj si pasojë e mbledhjes së djeshme gjashtorëshe, pa lëvizur prej karriges së drunjte - pak edhe si pasojë edhe e gjithë përjetimeve politike e shpirtërore në pranverën e sivjetme - shumë më tepër.

Natën, deri vonë pas mesnatës, u dëgjuan lëvizje automjesh: ose vijnë tanët - pjesëtarët e UÇK-së, ose shkojnë ata që po shkojnë - serbët, ose qarkullojnë britanikët që mbajnë Prishtinën.

Mëngjesi është i kthjellët, xham, me diell. Ajri është jo pak i ashpër në krahasim me ajrin përkëdhelës të Tiranës në këtë kohë.

Mbeta pa m'u kontrolluar shtëpia me detektor. Specialistët britanikë për këtë kontroll kurrsesi të vijnë! E, pa u kontrolluar shtëpia me detektor, nuk mund t'i vihen dyer e dritare, nuk mund t'i vihen xhamat, nuk mund të lëshohen instalimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit, nuk mund të hyhet brenda, më është thënë prej shefit të OSBE-së, Dan Evertsit.

Kam të ftohtë! Më mërdhijnë sidomos këmbët! Më vjen ftohtë në fund të qershorit - çfarë burri jam unë që mërdhij në pikë të verës! U mësova me butësinë e Tiranës. Më me qejf tani do të jetoja në Tiranë se në Prishtinë, edhe pse Prishtina në të vërtetë është vendlindja ime e dytë, siç janë Vuthajt është Vuthaj vendlindja ime e parë.

“Paske lindur dy herë” - do të më thonë me shaka humoristët tanë, qe sa vjet të heshtur. Po, po, dy herë, do t'u përgjigjem: herën e parë në Vuthaj, ku isha si zog i lirë, dhe herën e dytë, tani, mbasi u dëbuan pushtuesit, në Prishtinë. Tirana i ka rrugët të tmerrshme, me shumë gropa e shumë pluhur, por e ka klimën të butë, përkëdhelëse, kurse rrethinën të mrekullueshme, përplot gjithfarë gjelbërimesh. Pas më tepër se tre muajsh të kaluar në Tiranë, tani kam mbetur gjysmë në Prishtinë e gjysmë në Tiranë. E kuptueshme: Atdheu ynë i përbashkët, i të gjithëve, janë Shqipëria dhe Kosova - Shqipëria etnike.

## 29.6.1999

Mbahet mbledhja e Qeverisë së Përkohshme.

U vonova një orë dhe u vonova një orë sepse nuk pata me çka të shkoj prej njërit skaj në skajin tjetër të Prishtinës, ku mbahej mbledhja.

Mbledhja, teksa kishte filluar, dhe kishte filluar pa rend të ditës.

E kryesonte kryeministri, Hashim Thaçi.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e trembëdhjetë partive e lëvizjeve, kurse e katërbëdhjeta, partia e myslimanëve, nuk ishte e përfaqësuar, sepse kryetari i saj ishte në udhëtim.

Nuk erdhën partitë, të cilat kishin pësuar disfatë pas krijimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Liberale dhe Partia Socialdemokrate.

Diskutuan shumica e përfaqësuesve të partive që kishin ardhur në mbledhje. Fola dhe unë.

Dhe, fola për këto çështje:

1. për nevojën e shpjegimit, objektiv, të gjendjes politike e shoqërore në Kosovë; kurse parakusht për një shpjegim të këtillë është lirimi prej euforisë dhe retorikës;

2. për nevojën e organizimit tonë të brendshëm përkatës e jo të mbesim kështu sot e ashtu nesër;

3. për nevojën e inkuadrimin përkatës të subjekteve tona partiake në administratën ndërkombëtare të protektoratit;

4. për nevojën e sjelljeve tona me përgjegjësi ndaj të gjitha pakicave etnike, duke përfshirë këtu edhe serbët, që nuk i kanë bërë duart me gjak gjatë luftës.

Diskutimet, në përgjithësi, ishin të matura e korrekte, por kryesisht të përcipta.

Kam drojë prej mendimeve euforike të shumicës së atyre që po bëjnë politikë në emrin tonë!

Kam drojë prej atyre, diskutimet e të cilëve tregojnë se shohin vetëm deri te kthesa e parë.

Mbledhjen e mbylli Mehmet Hajrizi.

### **30.6.1999**

Mbahet mbledhja që e kryeson i deleguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, De Mello.

Na informoi për mbledhjen që ka mbajtur në Graçanicë dhe tha se do të na informojë për punën e komisioneve, se do të paraqesë idetë për një organ më të gjerë, që do të na ndihmojë në kryerjen e punëve të protektoratit, se do të dëgjojë me vëmendje vërejtjet tona, se do të dëshironte t'u shmangemi polemikave dhe të krijojmë formulime të përbashkëta.

Do t'ju informoj, tha mandej, shkurt për çështjen e mjeteve të informimit, që është detyrë urgjente për ju e për ne. Dhe na informoi.

Në vazhdim, De Mello paraqiti emrat e të gjithë atyre që do të përbëjnë këshillat dhe komisionet e ndryshme.

Në fund tha: nuk dëshiroj t'i bëni publike diskutimet tona nga këto mbledhje.

Nuk kuptova dhe nuk pyeta pse tha kështu: pse nuk dëshiron t'i bëjmë publike ato që thuhet dhe vendosen në këto mbledhje.

Në demokraci haptësia e transparenca e jo mbyllësia është e rëndësishme.

## **1.7.1999**

E enjte.

Ditë e mirë.

Shkova në Institut, në Institutin Albanologjik.

Shihet bërlllok, çohet pluhur, duket shkretueshëm. Askush, vërehet, s'bën gjë për t'ia kthyer Institutit fytyrën që kishte dikur.

Zyra ime krejt e shkretë: është marrë tryeza e punës, është marrë tryeza e vogël, janë marrë karriget, është marrë stufa elektrike, që e lëshoja kur s'kishte ngrohje në radiatorët. Fotografia e Naim Frashërit, e vënë në ballë të zyrës dhe piktura e Zakes, Zake Prelvukajt, janë shpuar në disa vende me thikë apo bajonetë pushke.

Mbas kësaj ardhje dëshpëruese në Institut shkova në shtëpi: ta shoh a po merr frymë. Aty, para shtëpisë, gjeta Jahirin, Jahir Ahmetin. Jahiri i jashtëzakonshëm, më i miri, më i virtytshmi

i Institutit Albanologjik, po kujdesej për shtëpinë time: kishte sjellë dy mjeshtër, të cilët kishin filluar të vinin dyer e dritare të reja në vend të të prishurave, të vinin xhama aty ku mungonin, të bënin meremetime në shtëpinë e plagosur rëndë prej shpërthimit që kishin bërë para dyerve të saj paramilitarët serbë me 26 mars 1999!

Dëmet, që i janë shkaktuar shtëpisë, janë më të mëdha se ç'kisha menduar. Pjesa e përparme e shtëpisë është bërë shoshë prej plumbave, që kriminelët serbë, sigurisht, kishin futur në eksplozivin që e kishin plasur.

Pasdite erdh Akseli, gjermani tani i punësuar në administratën e OKB-së, të kryesuar nga De Mello, që përpara kishte punuar në ambasadën gjermane në Beograd. Më thotë se do të mbahet një takim midis serbëve e shqiptarëve, në të cilin do të shqyrtohet çështja e sigurisë. Dhe, më pyet: a dua të marr pjesë në atë takim? I përgjigjem: po.

Mbledhja mbahet nesër në orën 10 e 15 minuta, thotë.

S'e di pse, por më tepër se një mosdurim, ndiej një si neveri ndaj disa veprimeve që bëhen dhe disa fjalëve që shqiptohen në jetën tonë politike sot. Më duket vetja i banalizuar pse marr pjesë në këtë jetë politike. A jam në vete? E kam braktisur krijimtarinë shpirtërore dhe merrem me gjëra me të cilat merren kudo e kurdo në radhë të parë mediokritetet.

## 2.7.1999

Marr pjesë në mbledhjen që ka caktuar KFOR-i, në të cilën janë ftuar përfaqësues politikë shqiptarë e serbë.

Mbledhjen e kryesojnë gjenerali britanik, Majk Xhekson, dhe i dërguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Serxho de Mello. Nga ana shqiptare, në mbledhje janë: Kolë Berisha, Blerim Shala, Hashim Thaçi dhe Rexhep Qosja. Nga ana serbe janë: dy klerikë, që i shoh për herë të parë, tregtari politik Momçillo Trajkoviç dhe fosili komunist, Dushan Ristiçi.

Mbledhjen e hap Serxho de Mello. Dhe, menjëherë ia jep fjalën gjeneralit Xhekson.

Gjenerali Xhekson, i cili as me pamjen e as me gjestin nuk të lë shumë përshtypjen e gjeneralit, flet shkurt: për sigurinë e pasigurt të qytetarëve.

Mbas fjalës së tij hapet diskutimi.

Diskutojnë të gjithë pjesëmarrësit - shqiptarë dhe serbë.

Në fund të diskutimeve, De Mello thotë se mbledhja duhet të mbyllet me një deklaratë të përbashkët. Tekstin e kësaj deklarate e sjell gjermani bulçimadh, Aksel.

Në këtë deklaratë, në rreth tetëdhjetë për qind të tekstit të saj, bëhet fjalë për serbët e në rreth njëzet për qind të tekstit të saj bëhet fjalë për shqiptarët!

E çuditshme!

E pakuptueshme!

E palejueshme!

Pastrimet etnike, dhuna e terrori me vite, krimet ndaj civilëve - të gjitha këto në njëzet për qind të tekstit quhen vetëm padrejtësi ndaj shqiptarëve, ndërsa në vazhdim, në tetëdhjetë për qind të tekstit, flitet për të ashtuquajturin eksodin e serbëve dhe për krimet ndaj tyre! Dhe, në këtë mënyrë, barazohen, plotësisht barazohen, dhuna dhe terrori shtetëror i ushtruar me vite ndaj shqiptarëve, krimet ndaj civilëve shqiptarë, pastrimi etnik i shqiptarëve, zhvendosja e dhunshme e rreth një milion shqiptarëve, me të ashtuquajturin eksodin serb dhe me sjelljet e papërgjegjshme të disa individëve ndaj disa serbëve!

Heshtje!

Nuk e kërkon fjalën askush!

Nuk e çel gojën askush!

E marr fjalën unë.

Shpreh mospajtim me deklaratën e paraqitur.

E kundërshtoj vendosmërisht logjikën absurde, papërgjegjësinë, qëllimin e paetikë politike të hartuesit të deklaratës. Bëj edhe disa vërejtje të tjera të vogla.



Mbas diskutimit tim fillon debati për deklaratën.

Prej diskutimeve të tyre shihet qartë se serbët, megjithëse e kanë humbur luftën, megjithëse në vazhdimësi i dënon bashkësia ndërkombëtare për krimet në Kroaci, për krimet e gjenocidin në Bosnjë e Hercegovinë dhe për krimet e pastrimit etnik në Kosovë, nuk e kanë ndryshuar aspak qykën!

Nuk e lëshojnë lehtë ata pozitën e sundimtarëve. Dhe, sado e kanë humbur pozitën e sundimtarëve, nuk heqin dorë lehtë prej gjuhës së sundimtarëve!

Shoh se Hashim Thaçi dhe Blerim Shala janë të gatshëm ta nënshkruajnë këtë deklaratë!

Duan të krijojnë karrierë e karriera sot krijohet duke u lëshuar pe ankesave të serbëve dhe duke lajkatur ndërkombëtarët!

- Ju po më lini vetëm, nuk po më ndihmoni, - iu them.

Përgjigjet Hashimi:

- Jo, profesor, nuk të lëmë vetëm! Thuaj çka të bëjmë!

Ju them:

- Të mos pajtohemi që të lëshojmë deklaratë sot. Ka kohë për deklarata! Kjo s' duhet të nënshkruhet! Kurrsesi!

Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Serxho de Mello, e vazhdon trysninë e tij të sikletshme ndaj nesh për të miratuar me çdo kusht deklaratën sot.

Më afrohet Blerimi:

- Ta nënshkruajmë, - thotë.

E shikoj hidhërueshëm. Dhe i them:

- Ti, kur diskutove, propozove që të krijohen grupe të përbashkëta serbo-shqiptare për të ruajtur kishat e manastiret! Naivitet! Gabove fort! Kur janë rrezikuar këtu kishat e manastiret serbe? Kurrë! Kurrë qe 500 vjet!

- Jo, profesor, - më përgjigjet, - ti s' e di, se janë djegur a prishur disa kisha serbe gjatë luftës e pas luftës.

- E di, - i them, - se serbët po gënjejnë me të madhe dhe rastet e veçanta po i bëjnë politikë. Nuk guxojmë të biem në grackat e tyre. Dhe, mos bëj më këso gabimesh siç bëre me atë propozim dhe siç je i gatshëm të bësh tani.

De Mello këmbëngul: të nënshkruhet deklarata.

Akseli bën disa ndryshime të vogla në tekst.

Kalojnë shtatë orë e gjysmë prej se ka filluar kjo mbledhje.

Shtohen edhe disa ndryshime më me rëndësi dhe deklarata bëhet, sadopak, më e durueshme. Mospajtimi im me atë deklaratë, megjithatë, nuk shkoi kot.

E nënshkruajmë, të gjithë, pas fjalëve që thotë De Mello:

- Duhet të keni nderim për ne që kemi ardhur këtu për të mirën tuaj.

Marrim pjesë në konferencën me mediat.

Lexohet deklarata: shqip, anglisht dhe serbisht.

Deklaratën shqip e lexon Hashimi: mezi. E kuptueshme: ose s'ë duron lehtë atë tekst, ose e mundon sjellja nënshtruese ndaj hartuesve të deklaratës! Në përgjigjet që u jep gazetarëve që pyesin, Hashimi prapë bën disa gabime: flet për krimet që po iu bëhen serbëve duke harruar se mjetet e informimit do ta kapin për gjuhe!

Hashimi mendon për karrierë duke flijuar të vërtetat. Luftëtari i shquar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës po bëhet poltron!

Shkoj në shtëpi me ndërgjegje të rënduar pse, më në fund, edhe unë pranova ta nënshkruaj atë deklaratë.

Shkoj duke menduar: çka do të thonë për ne mbasi ta lexojnë këtë deklaratë ata të dashurit e të cilëve kanë përfunduar në varre masive a në liqene e puse të lumenjve në Serbi? Çka do të thonë ata që i kanë provuar tmerret e kallashnikovëve, të minave e të thikave të paramilitarëve serbë të Arkanit, të Sheshelit e të tjerëve? Çka do të thonë nënat që kanë mbetur pa fëmijët gjatë rrugës së tmerrshme të zhvendosjes së dhunshme prej shtëpive e tokave të veta në Kosovë?

Kërkoj ndjesë prej tyre.

### **3.7.1999**

E shtunë.

Në Institut u takova me tre amerikanë dhe një amerikane, që thanë se punojnë në Institutin për Zhvillimin e Demokracisë në Uashington. Duan të dinë se çka mendoj për zhvillimet e

sotme politike në Kosovë, për të nesërmen e partive të sotme, për marrëdhëniet mes subjekteve tona politike dhe, në fund, për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës.

Amerikania, tha, se kishte punuar një vit e gjysmë në Tiranë dhe e dinte shqipen - mirë.

Bisedojmë rreth dy orë.

Lexuesi i këtij Ditari, që ka lexuar librat dhe shkrimet e mia për çështjen e Kosovës dhe çështjen shqiptare në përgjithësi, për rolin e partive politike ndaj kësaj çështje dhe për marrëdhëniet e tyre të sotme, mund të dijë e mund të mendojë se çka e si u jam përgjigjur pyetjeve që m'i bënë tre amerikanët dhe amerikania.

I përcjell deri në hyrje të Institutit.

Ndahemi me përzemërsi të theksuar.

Vijnë, në shtëpi, Hydajeti dhe Dani, Ramadan Avdiu, Nesër do të kemi takim me senatorin e njohur amerikan, Robert Dolin, i cili ka ardhur sot prej Uashingtonit, dhe Hydajeti e Dani duan të merremi vesh se si do të paraqitemi ne në takimin me të.

Dhembjet e mesit kurrsesi të më pushojnë.

Po vazhdoi kjo gjendje, ngadalë do të bëhem invalid!

Në veprimtarinë politike ndihem si në shkretëtirën e Saharës. E pres ditën e ikjes prej saj.

Para se të vdes duhet të shkruaj edhe për disa vdekje që më vijnë prej... prej syve të këqij!

#### **4.7.1999**

Takimi me senatorin amerikan, Robert Dolin, mbahet në hotelin *Dea*, që i është dhënë për shfrytëzim të përkohshëm UÇK-së.

Nga Lëvizja e Bashkuar Demokratike jemi unë dhe Hydajeti.

Me Robert Dolin, për herë të parë jemi takuar në zyrën e tij në Senatin amerikan, në vitin 1990, ne, gjithë anëtarët e grupit të kosovarëve shqiptarë që ishim të ftuar prej Kongresit Amerikan

në takim me grupin e serbëve nga Serbia dhe Kosova. Senatori duket mjaft i vyshkur.

Pleqëria shtatëdhjeteshtatëvjeçare ka lënë shenja në fytyrën e tij, dikur shumë të pashme.

Lëvizjet e tij janë dukshëm të ngadalësuara.

Fjalët e tij thuhet me zë më të ulët e me ritëm më të ngadalhtë.

E fillon bisedën me ne i gëzuar, thotë, por biseda është disi e vështirësuar! I është shterur imagjinata, i përsërit idetë dhe fjalët. Fraza stereotipe që prej tij i kishim dëgjuar edhe në Uashington shumë vite më parë.

Tregon se do të takohet me përfaqësuesit e të gjitha “fraksioneve” politike. Dakord. S’e pengon kush. E përmend kryetarin e LDK-së, Rugovën. Nuk e pengon kush që t’ia sjellin prej Italisë, ku po zhgërryhet në bollëkun pervers politik italian, të cilit i ka dhuruar mjaft nënshtrime retorike e praktike ndaj dhunës e terrorit të Sllobodan Millosheviqit në Kosovë, qoftë edhe me “zgjedhjet e lira e demokratike” nën atë dhunë e terror!

Biseda e Robert Dolit me ne zgjat 30 minuta - sa kishte premtuar se do të na nderonte.

Posa shkon Robert Doli, vijnë Hashim Thaçi, Mehmet Hajrizi dhe Jakup Krasniqi - në takimin e caktuar, pas nesh, me Dolin. Por, senatori Robert Doli, teksa kishte shkuar! Hashimin, Mehmetin dhe Jakupin i pushton një dëshpërim i bashkuar me panik! Si ishte e mundshme të shkonte Robert Doli pa u takuar me ta - me përfaqësuesit e UÇK-së, ndërsa ishte takuar me Bujar Bukoshin! I mbesin në qafë Hydajetit: pse nuk ishte përpjekur ta ndalte Dolin? Ju them:

- Mos u mërzitni aq shumë! Ka harruar Robert Doli se duhej takuar edhe me ju pas dy takimeve që kishte pasur më përpara. Ai me sjellje e me të folur linte përshtypjen e plakut të lodhur. I ka 77 vjet. A e keni parë si ishte tharë? E 77 vjet në politikë janë më rrënuese se 77 vjet në jetë të zakonshme! 77 vjet të pasanikut përplot përpjekje për pasuri nuk janë të njësojta si 77 vjet të

fukarasë, të cilin zoti e ka liruar prej ambicieve e dërrmimeve për pozitë politike e për pasuri.

Hashimi vlon prej hidhërimit!

Pse jo! I ishte cenuar prestigji i paqenë i kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme, të panjohur prej Dolit amerikan dhe dolave të LDK-së!

Mehmeti i sikletosur fort e mundonte Hydajetin: pse s'e ke përkujtuar, pse s'e ke caktuar saktë takimin, pse ashtu e pse kështu?

Jakupit i ishte mbyllur goja me nëntë brava!

Befasohem! Befasohem pse po brengosen aq shumë pse u ka ikur rasti që të takohen me Robert Dolin. Dhe befasinë e tregoj duke qeshur kur pafajshëm e kur ironikisht.

Mendoj: kështu e kanë kandidatët për karrierë politike, të cilët, kur me arsye e kur pa arsye vlerën nuk e gjejnë në veten e vet, po në ata me të cilët do të takohen! Janë të rinj, përplot ambicie pushtetore. Turren nëpër shkallët e pushtetit pa u lodhur sa të rrezikshme mund të jenë ato.

Turrin e tyre me dashje a pa dashje e ushqejnë zotërinjtë e protektoratit ndërkombëtar administrativ edhe ushtarak.

Në orën 14 me Hydajetin shkojmë në Kuvendin e Lëvizjes Popullore të Kosovës. I përshëndes, shkurt.

Pas përshëndetjes u desh të dalim dhe t'i gëzojmë Hashimin, Mehmetin dhe Jakupin: Hydajeti ka arritur ta ricaktojë takimin e tyre me senatorin Robert Dol.

Sot ka ardhur bija ime e madhe, Viola: ka ardhur prej Gjenevës ku kishte jetuar 11 vjet.

Na sjell bukurinë dhe gjallërinë e saj me të bijën, Vesën, dhe me të birin, Lekën.

Na sjell një mendimore plot me të dhëna për përjetimet dhe përpjekjet e saj që t'u ndihmojë nënës e motrës në Prishtinë gjatë fushatës së bombardimeve.

Na sjell gëzimin e saj të pamasë pse, më në fund, po takohet me nënë e babë e motër të gjallë.

## 5.7.1999

E kaloj ditën në banesë dhe në Institut. Shikoj fletoret e *Ditarëve* të 33 vjetëve, që m' i solli Artani, tek i cili i kisha fshehur dikur. Kanë shpëtuar në bodrumin e Naxhies, prandaj iu vjen era myk e dhé. Më tepër se 3000 faqe. Kur e kam dëgjuar shpërthimin dhe e kam parë tymin që po dilte prej shtëpisë sime me 26 mars, më kishte kapur tmerri: do të më digjet biblioteka e në bibliotekë do të më digjen edhe *Ditarët*. Vetëm ndonjë minutë më vonë, mbasi ishte shpërndarë tymi, m' u kishte kujtuar se *Ditarët* i kisha fshehur në bodrumin e banesës së Naxhies, vitin e kaluar, kur në gazetën *Koha ditore* më ishte botuar intervista në të cilën kisha mbrojtur UÇK-në prej sulmeve komprometuese të kolonës sonë të pestë në radhët e LDK-së.

## 6.7.1999

E martë.

Shkoj te shtëpia, por ende nuk hyj në të. Mjeshtrit po punojnë dhe dalëngadalë po e bëjnë të mirë e të sigurt për banim. Janë vënë dyer e dritare të reja në katin përdhes e të parë dhe janë vënë pothuaj të gjithë xhamat, janë përforcuar shkallët. Të gjitha dhomat, e me to edhe biblioteka, janë pastruar prej ndotësive që kanë lënë milicët dhe paramilitarët me çizmet e tyre derisa kanë plaçkitur çka u kishte pëlqyer: gjithçka të re e të vjetër, të rëndësishme e të parëndësishme, të vlefshme e të pavlefshme, të kuptimshme e të pakuptimshme, të shtrenjtë e të lirë - stolitë e arta e të tjera të Shpresës, palltot e gjata e të shkurtra të Shpresës, këpucë e çizme të saj, këpucë e këmisha të miat të papërdorura, çantë me stilografët dhe kimikët e mi të dhuruar prej bashkatdhetarë në Amerikë dhe në Evropë. Çuditërisht: asnjë libër nuk ishte marrë dhe nuk ishte shkelur, megjithëse pjesa më e madhe e tyre ishin hedhur prej dollapëve në dysHEME. Plaçkitësit

i kishin hedhur ashtu librat, sigurisht duke kërkuar se çka mund të kishte të fshehur pas tyre.

U dogjëm prej vapës në banesën e Dulit e të Ditës: e djeg dielli gjithë pasditen.

Për herë të parë pas dyzet e pesë vjetëve - sa jetoj në Prishtinë, ndiej nevojë të jem larg, larg, larg sa më larg prej vendit ku kam përjetuar shumë të mira, por, në fund, ku kam parë e përjetuar aq shumë vuajtje, aq shumë dhunë e terror, aq shumë vdekje.

Kam nevojë për vetmi, që më bën të mundshme lirinë për përsiatje.

Më neverit etja e madhe pushtetore e këtyre djemve të rinj pas tmerreve nëpër të cilat kanë kaluar gratë, nënat, motrat, bijat, fëmijët, pleqtë - të gjithë shqiptarët, që s'kishin pushkë në dorë. S'e di: këtë etje e nxit më shumë përkushtimi ndaj vetes e të vetëve apo ndaj të gjithëve, ndaj së mirës vetjake a ndaj së mirës së përgjithshme. Do të shihet pas ndonjë viti.

## **7.7.1999**

Në takim me zëvendëssekretarin shtetëror amerikan për Ballkanin, Dabit, i cili tani zëvendëson Gelbartin.

Me të është edhe ish-shefi i ish-Vëzhguesve, Shon Bernsi i jashtëzakonshëm.

Takimi bëhet në zyrat e Qeverisë së Përkohshme.

Në takim ishin edhe Mehmet Hajrizi, Basri Musmurati dhe Bajram Kosumi.

Zëvendëssekretari për Ballkanin do të dijë si e shohim ne gjendjen politike dhe si mendojmë se do të organizohen subjektet politike dhe, në përgjithësi, kosovarët brenda administratës ndërkombëtare të protektoratit.

Fola i pari.

Në fillim fola për rëndësinë e fushatës ushtarake të SHBA-së - bombardimeve për Kosovën, për rajonin dhe, madje, për

njerëzimin. E theksova kështu - edhe për njerëzimin, sepse në Kosovë, thashë, u mbrojtën vlerat e qytetërimit - të drejtat e njeriut, humanizmi, parimet dhe vlerat e demokracisë. Përvoja e krijuar në Kosovë, pas ndërhyrjes së NATO-s, e bën të pamundshme mbrojtjen dhe mbajtjen e tiranive, despotive e diktaturave në Evropë dhe në botën Perëndimore në përgjithësi. Në Kosovë, në të vërtetë filloi ndërtimi i rendit të ri botëror për shekullin XXI, i bazuar në sistemin e të drejtave të njeriut. Vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund ta bënin dhe ta arrinin këtë qëllim epokal. Atyre kjo edhe iu takonte, them në fund.

Zëvendëssekretari Shtetëror amerikan për Ballkanin, Dabit, thotë se i dëgjoj me shumë kënaqësi këto fjalë. Ashtu edhe vetë e kishte shikuar fushatën ushtarake të NATO-s në Kosovë e për Kosovën. Ashtu, më në fund, me atë qëllim të gjerë, ajo edhe është paramenduar. Rezultatet po shihen: në Jugosllavinë e mbetur tani po protestohet kundër diktatorit Millosheviq.

Në takim folën edhe Mehmeti, Basriu dhe Bajrami dhe sollën të dhëna të reja, gjykime e vlerësime të çmuara, që e pasuruan kuptimisht bisedën tonë me zyrtarin e lartë të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Shon Bernsi gjithë kohën mbante shënime.

Në fund, Dabit na thotë se tani e tutje do të kemi takime më të shpeshta me përfaqësuesit amerikanë dhe do të kemi takime më të shpeshta me ta sepse në Prishtinë vijnë pesëdhjetë diplomatë amerikanë në Qendrën Amerikane dhe në Konsullatën amerikane, që do të hapet shumë shpejt.

## **8.7.1999**

E enjte.

U përgatita për takimin e nesërm me përfaqësuesit e OSBE-së në Kosovë me Dan Evertsin në krye, me të cilin, në këtë takim, do të jetë edhe Knut Volebek.



Në orën 18 e 30 minuta mora pjesë në Emisionin për Kosovën të RTSH-së, një emision jashtëzakonisht i thjeshtë, madje, i thjeshtësuar. Mentaliteti bolshevik edhe më tej i gulçon shumë nga emisionet e këtij televizioni, sidomos emisionin për Kosovën e në mënyrë të veçantë ato informuese. Thuajse nuk lejohen më informata për askënd dhe për asgjë përpos për Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, të krijuar në Rambuje. Emrat dhe fytyrat e Bujar Bukoshit dhe të Ibrahim Rugovës në këtë emision më nuk mund të shihen e as të dëgjohen! Gjatë, gjithë kohës, tregohet fytyra e kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme, Hashim Thaçi. Krejt emisionin e bëjnë dy ish-gazetarë të Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve të Prishtinës, domethënë të Lidhjes Komuniste të Kosovës, domethënë të Lidhjes Komuniste të Serbisë, domethënë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, njëri prej të cilëve gazetar që raportonte nga mbledhjet e organizatave komuniste në të cilat bëhej diferencimi ideopolitik pas demonstratave të vitit 1981. Ky ish-shërbëtor i ish-Komitetit Komunal të Lidhjes Komuniste tani ka gjetur zotërinj të rinj dhe u shërben po aq përlshëm si komisarëve komunistë atëherë!

Mjerë ne!

Prej një totalitarizmi kaluam në totalitarizmin tjetër, që, duket, do të jetë vetëm më i sofistikuar se ai!

### **9.7.1999**

Isha në Takimin me Knut Volebekun dhe me Dan Evertsin në zyrat e të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë, Serxho De Mello. Nga ana jonë në takim ishin dy përfaqësues të UÇK-së, Jakup Krasniqi dhe Hashim Thaçi, dy të LDK-së - Edita Tahiri e Idriz Ajeti dhe dy të LBD-së - Hydajet Hyseni dhe Rexhep Qosja.

I pari e mori fjalën Knut Volebeku, i cili tha disa mendime të përgjithshme për gjendjen në Kosovë e për qëllimet e OSBE-

së këtu, duke shquar nevojën për tolerancë e bashkëjetesë të bashkësive të ndryshme etnike.

Mandej, na pa ne, shqiptarët, se kush do të marrë fjalën. Dhe, e ndali shikimin tek unë, si më i vjetri që isha, pas Idriz Ajetit, dhe me këtë shikim sikur po më thoshte: urdhëroni, merreni fjalën.

Fjalën i pari, megjithatë, e mori Hashimi: sigurisht, mendonte se atij, Hashimit, me çdo kusht i takonte të fliste i pari.

Foli si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme, që nuk njihej prej ndërkombëtarëve, rreth njëzet e tre minuta, foli, pa u ndalur, pa iu marrë goja siç mund t'u ndodhte disa të tjerëve, kur e kur edhe atij.

Mendoj: mjeshtër, si shumica e mediokërve politikë, për të folur gjatë dhe për të mos thënë gjë!

Pas tij e mora fjalën unë. I theksova shkurt, brenda gjashtë minutash, këto çështje: e para, administrata ndërkombëtare as pas një muaji nuk po funksionon, kurse problemet po shtohen; e dyta, ende nuk është gjetur formula e përfshirjes së kosovarëve në këtë administratë; e treta, siç na është thënë, administrata ndërkombëtare mbulon sektorin humanitar, sektorin e rindërtimit, sektorin e kapaciteteve demokratike të jetës publike e juridike, por është lënë anash kultura e do të duhej të mbulohej edhe ajo; e katërta, janë lënë anash edhe mediat, që kërkojnë kujdes të veçantë, sepse ende janë të ngarkuara me përvojën komuniste të monopolizimit partiak; e pesta, çështja e punës dhe e punësimit po “zgjidhet” sipas çelësit 1 me 1, domethënë 1 serb a malazez dhe 1 shqiptar. E kjo do të thotë shkelje e të drejtave të njeriut, sepse shqiptarët përfaqësojnë mbi 90 për qind të popullsisë në Kosovë. Një punësim i këtillë do të bëhet pengesë për procesin e demokratizimit të shoqërisë kosovare; e gjashta, zhvendosja e dhunshme e shqiptarëve prej komunave të Preshevës, Bujanocit e Medvegjës e keqëson gjendjen edhe ashtu të rëndë të sigurisë në Kosovë, prandaj duhet të ndalet ajo dhunë e regjimit serb atje, që të pengohen rastet e ngjashme të dhunës ndaj serbëve që nuk kanë marrë pjesë në krimet gjatë luftës këtu.

Në fund, i uroj OSBE-së suksese sa më të dukshme në veprimtarinë e saj të rëndësishme në Kosovë, për ndërtimin e demokracisë si institucione dhe si kulturë.

Diskutojnë edhe përfaqësuesit e tjerë të subjekteve politike shqiptare në këtë takim. Mbete me përshtypjen se më i përgatituri, më i suksesshmi ishte diskutimi i Jakup Krasniqit.

Në fund të takimit e mori fjalën Knut Volebeku.

Posa e nisi fjalinë e parë ai, u paraqit profesor Idriz Ajeti.

- Dua, - tha, - të them edhe unë një fjalë.

- Urdhëroni, - iu përgjigj Volebeku, i befasuar.

- Këtu, tha profesori, vetëm unë jam i pa identitet!

- Si është e mundshme kjo? - e pyeti i habitur Volebeku. - Nuk kuptoj për çka është fjala.

- Vetëm përfund emrit tim (në letrat me emrat e të pranishmëve këtu) nuk shkruan kush jam, e vazhdoi fjalën e tij profesori. Të gjithëve u shkruan diçka përfund emrit e mua asgjë!

- Çka do të doje të shkruante? - e pyeti tani nga pak me shaka Volebeku.

- Unë jam kryetar i Parlamentit të Kosovës, - vazhdoi profesori, - dhe kjo është dashur të shkruhet përfundi emrit tim.

- Bukur, - tha buzagaz Volebeku, - u zgjidh çështja e identitetit tuaj!

Pas kësaj fjale të Volebekut në sallën e takimit shpërtheu gazi.

Profesor Idriz Ajeti e bëri veten qesharak! Në të vërtetë, profesor Idriz Ajetin e qesharakëzuan ata të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që e shtynë të kërkojë identitetin e tij përmes tekstit që shoqëron emrin e tij për pozitën e tij në Kuvendin mosekzistues të Kosovës. Dhe, kështu, qesharakëzuesit e Kosovës, humnerizuesit e Kosovës, nën dhunën dhe terrorin e regjimit të Millosheviqit - udhëheqësit e gjorë të LDK-së, edhe në këtë takim e qitën profesorin në humnerë morale e profesionale! Profesori i shkretë! Nuk është në gjendje të kuptojë se Kosova sot është një njëmendësi e re, në të cilën nuk vlejnjë më ata titujt tragjikomikë të farkuar prej Fehmi Aganit dhe Ibrahim Rugovës nën pushtimin

e Knjaz Milloshit! Gjithmonë i përdorur prej njerëzve politikë të paskrupuj, ai vazhdon edhe sot të jetë i përdorur! Drejtohu, profesori ynë i dashur!

Mbledhja mori fund në një atmosferë qeshjesh!

Komedia dhe tragjedia në jetën tonë vazhdojnë të jenë të pandara edhe më tej prej atyre që këtë alkimi tragjikomike e salduan në kohën e Millosheviqit duke varur përtokas qafën e kokën dhe duke mbyllur si krepët gojën nën dhunën e terrorin e tij.

### **10.7.1999**

Gjithë ditën e kalova duke rregulluar bibliotekën.

Dhe, s'arrita ta rregulloj.

Dollapët me dokumente, dorëshkrimet e veprave të botuara, skedat e shumta, fletoret e shënimeve të ndryshme të bëra gjatë leximeve apo edhe gjatë përsiatjeve pa libër në dorë, dorëshkrimet e sprovave, trajtesave, artikujve dhe prozave të ndryshme më të shkurtra, duan shumë punë.

Policët dhe paramilitarët e, ndoshta, edhe udbashët serbë, të cilët kanë hyrë në këtë shtëpi pas shpërthimit të veturës me eksploziv para dyerve të garazhit, e kanë hedhur në dysheme gjithë lëndën e këtyre dollapëve!

Megjithatë, nuk i kanë marrë dhe nuk i kanë djegur!

Libri i fyer e mallkon fyesin!

### **11.7.1999**

Edhe sot punova për rregullimin e bibliotekës. Ngadalë ia kthej gjendjen dhe pamjen që kishte para hyrjes në të të policëve, paramilitarëve dhe udbashëve serbë gjatë bombardimeve në të.

Asnjë libër dhe asnjë dorëshkrim nuk e kanë zhdukur.

Çudi e madhe pse janë treguar aq të kujdesshëm ndaj librit dhe shkrimit.

Fuqia dhe bukuria e krijimtarisë shpirtërore qëndrojnë pikërisht këtu: para veprave të kësaj krijimtarije u merret fryma jo vetëm atyre që i duan, po edhe atyre që mund t'i urrejnë.

Serbët janë popull që e çmojnë krijimtarinë shpirtërore, por ndodh t'i vrasin krijuesit e saj! Librat e bibliotekës sime nuk i dogjën, por mua deshën të më vrasin.

### **12.7.1999**

U takova me dy francezë - përfaqësues të një institucioni të Francës, që merret me ndihmën për shoqëritë civile dhe multietnike. Me ta ishte Ymer Jaka.

Biseduam jo më tepër se një gjysmë ore.

Nuk isha i përgatitur t'u përgjigjesha me të dhëna konkrete për shoqatat dhe individët e goditur nga lufta në Kosovë, që do t'i ndihmonin ata teknikisht, financiarisht dhe edukativisht.

Mbeti të takohemi prapë, një ditë tjetër.

### **13.7.1999**

Mehmet Hajrizi më sjell me gojë ftesën për të marrë pjesë në takim me përfaqësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë, Serxho de Mello, në orën 14:00. Do të konstituohet Këshilli Kalimtar Konsultativ - organ që e themelojnë përfaqësuesit e Protektoratit në Kosovë.

Nga Lëvizja e Bashkuar Demokratike, në këtë takim do të marrim pjesë Mehmeti dhe unë. Do të humb kohë, por do të shoh e do të mësoj shumëçka në një takim në të cilin për çdo gjë vendosin të tjerët, ndërkombëtarët - sot Serxho de Mello, kurse pas tij Bernard Kushneri me bashkëpunëtorët e tij. E vlen të provojmë sa mund të ndikohet në vendimet e tyre.

## 14.7.1999

E mërkurë.

E mërkura është mesi i javës, thonë disa, por nuk është mesi i javës, sepse çdo ditë mund të shpallet mesi i javës, ashtu siç edhe çdo qytetar gojarisht mund të vetëshpallet kryetar i qytetit a i shtetit.

Vetëm krijuesit e arteve e të shkencave mund të shpallen sendësisht, me punën krijuese që bëjnë, se kush janë.

Mbledhja me përfaqësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së është shtyrë për nesër, në orën 15:00. Nuk më tregoi kush pse!

## 15.7.1999

Paradite erdhën Fatmir Toçi, Xhevat Lloshi dhe një mik i tyre, që quhej Nikolla Nosi. Më gëzuan. Do të jenë mysafirët e mi të çmuar. Fatmir Toçi me Shtëpinë e tij Botuese *Toena* është botuesi më i rëndësishëm i veprave të mia dhe njëri prej botuesve më të rëndësishëm shqiptarë sot. Por, Fatmiri është njëkohësisht edhe krijues. Xhevat Lloshi është kolegu im: ai është njëri prej studiuesve më të çmuar të gjuhës e të stilit.

Pas drekës me Jahirin, i cili i solli mysafirët në shtëpinë time, sepse vetë nuk do ta gjenin, shkuan të shohin Prishtinën e pasluftës.

Nuk deshën të flenë në shtëpinë time kur e panë edhe bijën time, Viollën, me të shoqin, Visarin, dhe me dy fëmijët - Vesën dhe Lekën, që sapo kishin ardhur prej Gjenevës. Do ta kalojnë natën në shtëpinë e Jahirit. Nuk u ndjeva mirë.

As sot nuk u mbajt mbledhja me përfaqësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Serxho de Mello.

Ka ardhur mjeku i njohur humanitar, Bernard Kushner, tani i dërguar (përfaqësues) i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm

të OKB-së për Kosovën. Serxho de Mello, ndërkaq, ishte përkohësisht në detyrën e administratorit të Kosovës. Shtyrja e mbledhjes prej të hënës i detyrohet ardhjes së Kushnerit sot a dje - nuk e di kur sigurisht, e jo vetëm mospajtimit të përfaqësuesve serbë për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit Konsultativ të Kosovës.

Gjendja në Kosovë vjen duke u qetësuar sadopak.

Dhe, ky qetësim, është më i shpejtë se ç'pritej.

Kjo nuk do të thotë, ndërkaq, se vdekja nuk i kërcënohet jetës edhe më tutje. I kërcënohet dhe do t'i kërcënohet edhe një kohë, ndoshta të gjatë. Mund të thuhet kështu sepse jetën dhe vdekjen në Kosovë me shekuj e përcaktojnë mitet, e aty ku në jetën e njerëzve përzihen shumë mitet, bëhen të paparashikueshme jeta dhe vdekja.

Pavarësisht çka flitet e shkruhet; pavarësisht pse Hashim Thaçi aq patetakisht po e thekson nevojën e kthimit të serbëve të zhvendosur; pavarësisht pse të gjithë po e shquajnë karakterin shumetnik të Kosovës, sot dhe nesër, e vërteta është se bashkëjetesa e shqiptarëve dhe e serbëve e malazezve, njëherë për njëherë, është e pamundshme. Përpjekjet e botës për ta rindërtuar këtë bashkëjetesë do të jenë gjatë punë Sizifi.

E kuptueshme: e kaluara shpesh përcakton plotësisht të sotmen.

## **16.7.1999**

Mbahet mbledhja e Këshillit që tani quhet Këshilli Kalimtar i Kosovës. Kështu e quajten përfaqësuesit e rinj të OKB-së në Kosovë Këshillin e Përkohshëm të Kosovës - organizimin këshilldhënës, që do të duhej t'i shqyrtonte të gjitha problemet dhe çështjet e jetës së qytetarëve dhe të së ardhmes së Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi i dërguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Bernard Kushner, kurse pranë tij qëndronte edhe administratori i deritashëm, Serxho de Mello.

Në mbledhje marrin pjesë edhe shefat e sektorëve, si dhe komandanti i KFOR-it, gjenerali britanik, Xhekson. Këshillin e përbëjnë edhe tetë shqiptarë: Mehmet Hajrizi dhe Rexhep Qosja, si përfaqësuesi të LBD-së, Hashim Thaçi dhe Xhavit Haliti, si përfaqësues të UÇK-së, Ibrahim Rugova dhe Edita Tahiri, si përfaqësues të LDK-së dhe dy të quajtur të pavarur, Veton Surroi dhe Blerim Shala, dy a tre serbë - peshkopi Artemije, Trajkoviqi dhe kleriku Jovan, myslimani Numan Baliq dhe një turk.

Në mbledhje nuk erdhën përfaqësuesit e LDK-së. Kanë thënë se nuk do të vijnë po s'u shtua numri i tyre: i përfaqësuesve të "institucioneve", të zgjedhur me pajtimin e Millosheviqit dhe i të "partive parlamentare", të legjitimuara nga ai! Kanë thënë se nuk do të vijnë në mbledhjet e këtij Këshilli Kalimtar po nuk u shtua numri i atyre që e kanë gërryer, shfrytëzuar, plaçkitur, mashtruar e fyer popullin gjatë nëntë viteve me politikën e tyre nënshtruese ndaj dhunës së Millosheviqit!

Bernard Kushneri është francez, me prejardhje prej Korsikës, prej nga ishte edhe Napoleon Bonaparti i madhërishtëm. Është krijues i Shoqatës së njohur humanitare *Mjekët pa kufij*, që ka luajtur dhe luan rol të madh me ndihmat që u jepen fatkëqijve të luftërave në krejt planetin e Tokës.

Bernard Kushneri është trupmesatar, më dukshëm i hollë se i plotë, me vija theksueshëm të rregullta të trupit dhe të fytyrës. Me pamjen e tij lë përshtypjen e intelektualit të rryeshëm, më shumë të përkushtuar aksionit, sesa meditacionit.

I pari, natyrisht, në mbledhje e merr fjalën Bernard Kushneri. Thotë se është i lumtur që është këtu. Qëllimi i atyre që e kanë caktuar dhe i tij është: vendosja e administratës qytetare (civile) në Kosovë. Këshilli i Përkohshëm (kalimtar) do të jetë organi kryesor që do të sendërtojë qëllimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara këtu, në Kosovë.

Në këtë Këshill do të trajtohen të gjitha çështjet me rëndësi për Kosovën. Dhe jo vetëm për Kosovën.

Nuk do të këtë votime.



Do të vendosë rëndësia, pesha, thotë ai, e argumentit.

Do të përpiqemi për konsensus, por kur konsensusi do të mungojë, do të vendosë ai - Bernard Kushneri.

Shkurt, qartë, vendosmërisht, Bernard Kushneri i tha kryesoret. Pas Kushnerit fjalën e mori Serxho de Mello.

Do të shkoj shpejt, tha.

I falënderoj për bashkëpunimin të gjithë ata me të cilët kam bashkëpunuar, tha.

Mbas Serxho de Mellos fjalën e mori Hashim Thaçi dhe foli më gjatë se Kushneri. Dhe foli edhe bashkimvëllazërueshëm.

Mbas Hashim Thaçit fjalën e mori peshkopi Artemije.

U pa menjëherë se ishte përgatitur mirë.

E shtroi problemin e zhvendosjes së serbëve *me dhunë*, tha ai.

Do të marrim pjesë në punën e këtij Këshilli, tha, vetëm në qoftë se ndalet eksodi i serbëve.

Mbas peshkopit Artemije fjalën e mori Numan Baliqi: natyrisht, në emrin e myslimanëve të Kosovës.

Ishte përgatitur mirë dhe foli shkurt.

Mbas Numan Baliqit fjalën e mori përfaqësuesi i turqve të Kosovës.

Mbas përfaqësuesit të turqve fjalën e mori Trajkoviqi, përfaqësuesi i serbëve.

Fjala e tij na përkujtoi se sa e padurueshme është demagogjia.

Mbas këtyre fjalëve, kryesisht ceremoniale, u bë një diskutim serioz në të cilin morën pjesë Bernard Kushner, Serxho de Mello, gjenerali Xhekson dhe të tjerë.

Gjenerali Xhekson vuri në dukje se në Kosovë tani po ndodhin djegie të shtëpive të serbëve dhe vrasje të serbëve, por tani në Kosovë po hyjnë edhe agjentë serbë nga Serbia.

Xhavit Haliti, në fjalën e tij e mbrojti UÇK-në prej sulmeve të peshkopit Artemije - e filloi mirë këtë mbrojtje dhe e përfundoi dobët.

Pas Xhavitit prapë fjalën e mori Hashim Thaçi: ishte e qartë se donte ta ndërronte përshtypjen e keqe që kishte bërë me diskutimin e parë!

Diskutimi i tij, kësaj here ishte shumë më i mirë sesa diskutimi i mëparshëm.

Mandej e quajtën të nevojshme ta marrin fjalën sërish edhe Kushneri, edhe Artemije, edhe Trajkoviqi, edhe Xheksoni, edhe komisari i policisë, Frederiksoni, edhe Numan Baliqi, i cili në diskutimin e tij e quajti të arsyeshme të theksojë se ka vrasje dhe djegie të shtëpive edhe të myslimanëve.

Veton Surroi, në diskutimin e tij, me të drejtë shtroi çështjen e pronës shoqërore! Dhe si të mos e shtronte? Mund të merret me mend se tani, në kushtet e kapitalizmit të paprovuar te ne, me këtë pronë, në procesin e privatizimit, do të bëhen gjithfarë keqpërdorimesh.

Peshkopi Artemije dhe Trajkoviqi në diskutimet e tyre pa ngurrim shfaqën agresivitet të papritur.

Mbas diskutimit të tyre agresiv, përfaqësuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Bernard Kushner, e quajti të nevojshme të theksojë se “Misioni i Kombeve të Bashkuara është i vetmi organ administrativ dhe ligjor në Kosovë sot”.

Mbledhja e sotme mori fund me fjalën falënderuese të Bernard Kushnerit dhe me fjalën lamtumirëse të Serxho de Mellos.

Tonin dhe ritmin e kësaj mbledhjeje, ndërkaq, e caktuan peshkopi Artemije dhe Trajkoviqi me vendosmërinë e tyre akuzuese: përfaqësuesit e xhelatëve ia imponuan viktimës temat dhe motivet e bisedës!

Nuk fola fare. Nuk desha të marr pjesë në diskutimin për serbët dhe vetëm për serbët sot, që na u imponua në regjinë e gjeneralit Xhekson! Desha të shoh e të kuptoj kush do të jetë, kush në këtë Këshill, i quajtur Kalimtar (Tranzitor).

Gjenerali Xhekson u largua prej kësaj mbledhjeje pak para përfundimit të saj. Kur bëri të çohet, peshkopi Artemije, përgjysmë fshehtazi e përgjysmë haptazi, nxori një shishe me pije, që nuk mund ta dija çfarë pije ishte, dhe ia dhuroi gjeneral Xheksonit, i cili e mori buzagaz plotësisht sheshazi. Nuk më befaso! Sjellja mitosëse e peshkopit Artemije - klerikët ballkanikë gjithmonë

kanë dhënë e kanë marrë ryshfet, por më befasoi sjellja e gjeneral Xheksanit, të cilin dinjiteti i ushtarakut të Mbretërisë së Bashkuar do të duhej ta detyronte që të mos merrte mito! Me këtë sjellje peshkopi Artemije tregoi se me gjeneral Xheksanin do të jetë takuar edhe më herët.

Ka kohë që turpeve në botën moderne nuk u vihen perde!

Dola i zhgënjyer nga kjo mbledhje.

Duhej të gjeja dikë të më çonte deri në shtëpi.

Të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje i kanë veturat e tyre: vetjake apo të subjekteve politike e partiake që përfaqësojnë dhe i kanë me gjithë vozitësit. Disa prej tyre i kanë dhe truprojat, të cilët i marrin gjithkund me vete. Vetëm unë jam gisht: pa veturë e pa vozitës! Kjo, domethënë, se çmimi im mes këtyre njerëzve të Këshillit Kalimtar të Kosovës është më i vogli, më i ulëti; të gjithë të tjerët vlejné më shumë se unë. Edhe pse forcat e armatosura serbe, më 26 mars 1999, kanë vënë autobombë para shtëpisë sime dhe e kanë bërë shoshë me teshë e koteshtë, duke treguar ashtu se kanë dëshiruar të më zhdukin me gjithë familjen, unë vazhdoj të shkoj në mbledhjet me përfaqësuesit e KFOR-it dhe të Misionit të OKB-së plotësisht i pambrojtur!

Edhe më tej mendoj se krijuesit e arteve e të shkencave nuk vriten lehtë. Dhe, nuk vriten lehtë sepse vrasja e tyre bëhet mallkim për vrasësit.

Në drekë, në shtëpi, kisha Fatmirin, Xhevat Lloshin dhe Nikollë Nosin. Si e mbaruam drekën, erdhi edhe miku im, Shemsi Reçica, me tre kushërinj. U mbush shtëpia.

Shpresës sime të dashur i teret fytyra: s'ka me çka t'i presë.

Kur bashkohen shqiptarë të Kosovës dhe shqiptarë të Shqipërisë shtetërore, bisedohet për çështje të veçanta, por të përbashkëta.

Pasdite shkova në mbledhjen e Kryesisë së LBD-së. Nuk ecin punët. Mehmeti, Hydajeti dhe Bajrami janë angazhuar në punët e Qeverisë së Përkohshme, i kanë marrë me vete edhe disa nëpunës të LBD-së, që i ka futur në ato punë Qeveria dhe u duken të parëndësishme punët e Partisë. Gjatë diskutimit, Bajrami, Bajram

Kosumi, tregon se e merr me aq heroizëm punën e Qeverisë së përkohshme, aq sa e nënçmon plotësisht punën e protektoratit.

I them:

- Përfaqësuesit e OKB-së, që e përbëjnë këtë protektorat administrativ dhe ushtarak, nuk kanë ardhur këtu për muhabete dhe pije, por për të sunduar.

- S'mund të mendojnë pa ne, - përgjigjet Bajrami.

- Dakord, s'mund të mendojnë pa ne, në të vërtetë do të bëhen se s'mund të qeverisin pa qytetarët e Kosovës, por ndoshta e dëgjuat Bernard Kushnerin kur tha:

“Misioni Ndërkombëtar është i vetmi organ administrativ e ligjor në Kosovë”.

Në qoftë se ne nuk dëshirojmë ta kuptojmë këtë që tha Kushneri, do të kuptojmë edhe çka s'tha, deshëm s'deshëm. Ashtu do të zhvillohen punët. Evropianët dhe amerikanët nuk e kanë adet të bëjnë shaka politike. Evropianët janë fuqi me tradita imperialiste. Por unë propozoj që të bashkëpunojmë me korrektësi me administratën ndërkombëtare, duke i ndërtuar edhe organet tona në bazë - deri në zgjedhje.

Diskutojnë të gjithë anëtarët e Kryesisë. A. Morina dhe Halit Jahjaga janë të preokupuar me çështjen e vendeve në qeveri. Pse jo: edhe ata të dy kanë kuaj shale për vrapim!

Me të drejtë reagojnë ndaj monopolit që në Qeverinë e Përkohshme kanë vënë LDSH-ja dhe PPK-ja e injorohen partitë e tjera brenda LBD-së.

Si në mbledhjen e Këshillit Kalimtar të Kosovës, ashtu edhe në këtë mbledhje, kam të njëjtën ndjenjë dhe të njëjtin mendim: po humbas kohën, domethënë po i largohem përfundimisht krijimtarisë. Nuk duhet të lejoj në asnjë mënyrë dhe për asgjë që kjo të më ndodhë.

Në mendje më silllet Xhezairi i Gjikës!

**17.9.1999**

Në orën 9:00, me Visarin, Visar Rekën, shkuam në takim me komandantin e KFOR-it, gjeneralin britanik, Majkël Xhekson.

Është i vendosur në ndërtesën e Kosova-filmit, në Dragodan.

E kanë ndërruar plotësisht pamjen e mjedisit ku janë vendosur anglezët e jashtëzakonshëm. Uniforma të bukura, automobila, autoblinda, tanke, helikopterë. Rend, rregull kudo, në të gjitha anët.

Në parazyrën e gjeneral Xheksonit më bie në sy një si tabelë jo shumë e madhe, në të cilën është shënuar orari i punëve të tij të sotme. Aty është i shënuar edhe takimi me mua.

Gjeneral Xhekson më pret në zyrë, i buzëqeshur, i çlirët.

Çohet e ulet afër meje.

Pyetja e parë që më bën pas disa fjalëve që diplomatët i quajnë fjalë kortezie është:

- Si ju duket situata sot? Si e vlerësoni gjendjen?

Heshtje e shkurtër.

- Ardhja e KFOR-it na ka sjellë shpresë për ardhmërinë.

Por, ende ballafaqohemi me shumë probleme që i shohim dhe presim probleme që nuk mund t'i parashikojmë. Disa prej problemeve që më duken më shqetësuese, sipas mendimit tim, janë:

1. ndarja e Mitrovicës, 2. prania e rusëve, sidomos në aeroportin e Prishtinës, 3. kërkesat që, edhe mbas të gjitha atyre krimeve që bëri regjimi i Millosheviqit ndaj nesh, Kosova është pa sistemin e vet të mbrojtjes, 4. përqendrimi i serbëve në Fushë të Kosovës, në Rahovec, në Shtërpcë, në rrethinë të Gjilanit, domethënë në enklava, që mund të bëhen enklava terrorizmi kundër nesh e kundër KFOR-it dhe 5. insistimi i Misionit të OKB-së në autonominë e Kosovës edhe pas kësaj lufte që bëri UÇK-ja bashkë me forcat e NATO-s gjatë fushatës së bombardimeve!

Gjeneral Xheksoni përgjigjet ngadalë, përqendrueshëm, ndaj të gjitha shqetësimeve të mia që ia numëroj.

Pranisë së rusëve nuk i kushton farë rëndësie.

Çështjen e sigurimit tonë, vetjak, të mbrojtjes sonë vetjake, e konsideron çështje shumë serioze, por shton se ushtria kushton shumë, kurse ne tani për tani jemi mbrojtje pa pagesë, thotë duke qeshur.

Drojën tonë nga përsëritja e autonomisë dhe “sovrانيتeti” nën Jugosllavinë e mbetur e mënjanon me pohimin se NATO prej Kosovës nuk do të shkojë pa u caktuar statusi përfundimtar i Kosovës.

Ndahem prej tij me përshtypjen: gjenerali Xhekson është anglez i vërtetë sepse është politikan i jashtëzakonshëm edhe kur është ushtarak.

Desha t’i thosha se në pjesën e Mitrovicës, në të vërtetë në krejt Mitrovicën dhe Veriun e saj, do të ishte mirë të shpallej gjendje e jashtëzakonshme, kurse në Kosovë të zbatohet i ashtuquajtura Plani i Marshallit, si në Gjermani pas Luftës së Dytë Botërore, që do ta rindërtonte Kosovën e shkatërruar nga regjimi pushtues gjakatar i Millosheviqit. Por, nuk i thashë!

## **18.7.1999**

Me drejtorin e Institutit, Sadri Fetium, shkuam në Medresenë *Alaudin* për të ngushëlluar familjen e Fehmi Aganit. Të pamen e kanë caktuar këtu, në Medrese, ndoshta pse Fehmiu ishte bir hoxhe e, ndoshta, pse shtëpinë e tij ende nuk e kanë bërë gati pas disa muajve jetese jashtë saj dhe jashtë Prishtinës.

Prej ngushëllimeve në Medresenë *Alaudin* shkuam për ngushëllime te familja e Bajram Kelmendit, por nuk gjetëm askënd në shtëpi. Fqinjët na thanë se pak më parë kanë dalë.

Tragjedia e Bajram Kelmendit me dy djemtë është tragjedi që e kam ndier shumë. Shumë shpesh edhe derisa isha në Tiranë kam menduar për këtë tragjedi të shokut tim të Normales së Prishtinës, Bajram Kelmendit. Krimet serbe në Kosovë ishin

shumë monstruoze, ishin shumë të përbindshme. Pas këtyre krimeve marrëdhëniet shqiptaro-serbe pashmangshëm do të kenë rrjedhë tjetër historike. Shoqëria qytetare me serbët është bërë pothuaj e pamundshme. Bashkëjetesa me serbë është bërë vërtet e pamundshme. Thuhet se francezët e gjermanët edhe mbas gjithë atyre luftërave shkatërrimtare mes tyre janë pajtuar, por serbët dhe shqiptarët nuk janë francezë e gjermanë, kurse historia e marrëdhënieve të tyre, franceze-gjermane, nuk është histori e marrëdhënieve shqiptaro-serbe.

### **19.7.1999**

E hënë.

Hënë nuk e pashë aspak natën.

Është ditë e lirë, pa takime me të huajt.

Pedagogu në Katedrën e Letërsisë dhe të Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Filologjisë, Isak Shema, që më ka dorëzuar dorëshkrimin e doktoraturës, të mërkurën, vjen të më pyesë nëse e kam lexuar.

E dëshpëroj:

- S'kam pasur kohë që ta lexoj, por do të bëj përpjekje që ta lexoj deri në fillim të javës tjetër.

Vuaj prej një pikëllimi të pandërprerë, sado kur më të zbutur e kur më të madh. Më pikëllojnë dhembjet e mëdha të shumë familjeve tona, që kanë mbetur kush pa djalë e kush pa djem, kush pa vajzë e kush pa grua, kush pa vëlla e kush pa vëllezër, kush pa babë e kush pa nënë. Kurrë më nuk do të mund të jem i lumtur siç isha përpara. Jam nënshkruar i Marrëveshjes së Rambujesë e cila Kosovës i ka sjellë shpresën për liri dhe pavarësi, por e cila u ka sjellë dhembje të fundbotshme qindra mijëra shqiptarëve, kurse shumë familjeve pikëllime të përjetshme. Kjo domethënë: kam meritë dhe kam faj; jam nënshkruar i gëzimeve që sjell fitorja dhe jam nënshkruar i pikëllimeve që sjellin sakrificat e bëra për

fitoren; jam i merituar dhe jam mëkatar! Gëzimin e kësaj fitoreje, natyrisht ende jo të kryer, dhe ende jo të kryer sepse na pret betejë e madhe dhe e gjatë politike dhe diplomatike për pavarësinë e Kosovës, ma cenojnë fort pikëllimet e nënave, të etërve për bijtë dhe bijat e tyre, të motrave për vëllezërit, të grave për burrat, të fëmijëve për prindërit, të gjyshërve e gjysheve për nipat e mbesat.

Koha, thuhet, shëron, por as kohën e as hapësirën s'i përjetojnë të gjithë njerëzit njësoj. Si i përjetoj unë do të shihet në romanet e mia.

## 20.7.1999

Jam zgjuar me dhembje të forta të eshtrave, të të gjithë eshtrave, që e mbajnë trupin tim të pakursyer e të stërmunduar.

Violla me të shoqin, Visarin, dhe me fëmijët, Vesën dhe Lekën, me të cilët tani jetojmë bashkë në shtëpinë time, kanë krijuar një stil jetese në Zvicër, në Gjenevë, që ndryshon plotësisht prej stilit tim jetësor dhe të Shpresës. Dhe, kështu, në shtëpinë time tani për tani jetohej me dy stile të ndryshme. Dhe, kjo më pengon; dhe kjo më shqetëson; dhe kjo më nevrikos. Dhe, kjo nuk më lejon kurrfarë paqe për krijimtari. Unë jam njeri me rend, me disiplinë jetësore, që ma ka mësuar puna vetëmohuese krijuese dhe nuk mund të kem mirëkuptim për jetën pa rend e pa disiplinë jetësore.

Ende nuk e di është më mirë të jetohej me një stil apo me dy apo me më shumë stile jetësore!

Unë me një stil spontan jetese mund të bëhem shpejt shumë më i mërzitshëm për të tjerët sesa ata me disa stile jetese.

Nuk çmohen kot stilet në krijimtarinë letrare dhe artistike në përgjithësi.

Në orën 10 në Institut u takova me përfaqësuesin e Bashkimit Evropian për organizatat humanitare, Zhan-Klod Hejrod. Interesimet e tij janë fare stereotipe, fare dogmatike, të dëgjua shumë shpesh e shumëkund dhe nuk më frymëzojnë përgjigje



të rëndësishme, madje as të vyeshme. Të huajt në Kosovë pashmangshëm interesohen për përtashësinë më të thjeshtë praktike politike dhe, kur e kur, shoqërore. E unë jam i prirë për shqyrtim idesh, konceptesh, parimesh, për shqyrtim të pritshmërisë e jo për shqyrtim të përtashësisë politike.

## 21.7.1999

E mërkurë.

Është fundi i korrikut.

Është një ditë nga më të shpeshtat brenda një viti: as dritë e kthjellët e as terr i vranët.

Lexoj librin me ngjarje dhe anekdota nga jeta e njerëzve të shquar - krijues, shtetarë, politikanë e komandantë, që ka botuar *Toena*. Përkthimi, ndërkaq, mund të ishte më i mirë se ç'është.

Pasdite në orën 16 u takova me një diplomat francez, përfaqësues i Ministrisë së Jashtme të Francës. Takohemi në zyrën time në Institutin Albanologjik.

Është vapë e padurueshme.

Ky diplomat, sipas të gjitha gjasave, është dërguar tek unë prej Bernard Kushnerit dhe është dërguar me qëllim për të më testuar nëse jam a s'jam i përshtatshëm, e kjo i përshtatshëm domethënë i përdorshëm, për të qenë anëtar i Këshillit Kalimtar të Kosovës, që e drejton ai, Bernard Kushneri. Diskutimi im në mbledhjen e fundit të këtij Këshilli e ka bërë të dyshojë se do të pajtohem me të gjitha ato që duhet të bëjë ky Këshill për të ringjallur “bashkim-vëllazërimin” jugosllav edhe pas luftës çlirimtare dhe pas bombardimeve të NATO-s në Kosovë e Serbi. Diplomati francez m'i bëri tri pyetje:

e para, si e parashoh të ardhmen e UÇK-së?

e dyta, çka mendoj për serbët në Kosovë, dhe

e treta, a jam i gatshëm të shkoj në takimet popullore edhe me prijësit serbë në Këshillin Kalimtar?

Në pyetjen e parë, iu përgjigja: me luftën e saj, çlirimtare, UÇK-ja është bërë organizatë e madhe, shumë e rëndësishme e kjo domethënë historike, në Kosovë. Tani për tani ajo do të jetë e shndërruar (transformuar) jo pse ne dëshirojmë ashtu, por pse ashtu po kërkojnë faktorët ndërkombëtarë.

Në pyetjen e dytë iu përgjigja: serbët që nuk kanë bërë krime gjatë luftës duhet të trajtohen si gjithë qytetarët e Kosovës, si shqiptarët e të tjerët, me të gjitha të drejtat e njeriut, të drejtat qytetare dhe demokratike.

Në pyetjen e tretë, iu përgjigja me një *po* dhe iu përgjigja kështu shkurt sepse nuk mund t'ia bëja qejfin edhe vetes edhe atij.

Në mbrëmje, diku rreth orës 18, në shtëpi më erdhi delegacioni i Kuvendit të Shqipërisë, në krye me mikun tim shumë të çmuar, Sabri Godo. Gjatë bisedës munda të vërej se Sabri Godo nuk ishte ai Sabriu që kisha njohur në Tiranë gjatë prillit, majit e qershorit të këtij viti. Luante një rol që nuk ia kisha njohur gjatë atyre muajve! Pas disa minutash bisede, Sabriu më thotë se unë, si duket, po ndikoja në qëndrimet e përfaqësuesit të OSBE-së në Kosovë, Dan Everts, ndaj LDK-së dhe në fund të këtij konstatimi më bëri edhe pyetjen:

- E ke mik ti Evertsin?

Më bëri këtë pyetje thujse kishte harruar plotësisht se së paku dhjetë herë më kishte thënë gjatë takimeve që kishim në Vilën 31 se Dan Evertsi ishte miku im që më çmonte shumë.

Më rrëzon për tokë kjo pyetje e Sabri Godos!

Përnjëherë para syve të mi del jo Sabri Godo i vitit 1999, po Sabri Godo i janarit e shkurtit të vitit 1992, kur më premtoi po nuk erdhi në Kuvendin e Pajtimit Kombëtar në Tiranë.

Ishte ky një Sabri Godo makiavelist.

Më pikëlloi ky mendim që për të ia thashë Unit tim të dytë.

E doja dhe e çmoja Sabriun e sivjetmë, të vitit 1999, por jo Sabriun e vitit 1992.

Kush e di edhe sa dëshpërime do të përjetoj në këtë punë politike në qoftë se më lënë mendtë e kresë dhe vazhdoj të merrem edhe ndonjë vit me të!

I ftoj për drekë, nesër, në shtëpinë time.

- Jemi të ftuar prej Qeverisë së Përkohshme, - më përgjigjet Sabri Godo.

I përcolla deri te dera e oborrit.

- Dua të shihemi nesër, - më tha të vogël Sabriu, derisa po lamtumirehim.

E dija se nuk do të shiheshim: ai nuk do të mund të takohej nesër me mua sepse frikësohej prej deputetëve të Partisë Demokratike dhe të Legalitetit që ishin në përbërjen e delegacionit. Prania e tyre në delegacion e kishte bërë Sabri Godon të më bënte edhe pyetjen lidhur me Dan Evertsin dhe LDK-në, domethënë e kishte bërë të tregohej makiavelist.

## 22.7.1999

U takova me përfaqësuesin e Misionit amerikan në Prishtinë, intelektualin me emrin bukurtingëllues, Lari Rosin.

Bisedojmë në zyrën e Hydajet Hysenit në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. Është i pranishëm edhe Hydajeti.

Bisedojmë për mjaft çështje të përtashme.

Flasim shkoqur, pa ngurrime.

Flasim thuajse ishim të bindur se edhe ai do të pajtohej plotësisht me të gjitha që do të thoshim unë dhe Hydajeti

E ai, Lari Rosini, vërtet u pajtua me ato që thamë.

Vërejmë se ka dallime në qëndrimet e tij me qëndrimet e Bernard Kushnerit dhe të diplomatëve të tjerë francezë dhe gjermanë.

Amerikanët dhe britanikët më hapur dhe më vendosmërisht mbajnë anën tonë sesa ndërkombëtarët e tjerë në Kosovë apo jashtë Kosovës. Francezët dhe gjermanët, ndërkaq, mbajnë njëkohësisht anën tonë dhe anën e serbëve!

- Do të kujdesemi, - tha, - që gishtërinjtë e Jugosllavisë (së mbetur) të mos përzihen në Kosovë.

U ndamë me përzemërsi të veçantë me Lari Rosinin.

Pasдите takohem, në shtëpinë time, me këshilltarin politik të komandantit britanik në Kosovë, Majk Xheksonin.

Mendoj, derisa e dëgjoj duke folur: mirë, shumë mirë në qoftë se me të vërtetë mendon siç flet e, siç po shihet, mendon ashtu siç mendonte përfaqësuesi i Misionit amerikan në Kosovë, Lari Rosin.

Pas këshilltarit politik të komandantit britanik në Kosovë, Majk Xhekson, erdhi në takim, po ashtu në shtëpinë time, një diplomat i ri gjerman dhe erdhi me një përkthyes shqiptare, të cilën nuk e kisha takuar ndonjëherë tjetër. Ma sollën orarin e udhëtimit në takimin nesër në Prizren, me kancelarin gjerman, Gerhard Shreder. Mbas pyetjes sime nëse duhet të shkoj i vetëm në atë takim apo mund të marr edhe dikë tjetër, diplomati gjerman m'u përgjigj buzëqeshur:

- Merrni kë të doni.

Dhe kjo përgjigje e tij m'u ndal në mendje si përgjigje shumë më liridashëse se ç'ishin përgjigjet e tjera të ndërkombëtarëve në Kosovë ndaj pyetjeve tona.

### **23.7.1999**

E premtë.

Në orën 13:00 me helikopter ushtarak gjerman fluturuam për në Prizren. Fluturuam me dy helikopterë: në njërin jam unë me Visar Rekën dhe me Sabri Kiçmarin, kurse në tjetrin është Hashim Thaçi me Edita Tahirin.

Prej lartësisë, që nuk është e madhe, shikoj fshatrat mes Prishtinës dhe Prizrenit. Rrëtime të mëdha. Shumë, shumë gërmadha kanë hapur gojën drejt qiellit dhe ose i luten Zotit për mëshirë ose mallkojnë egërsinë ushtarake-police-paraushtarake serbe, që aq pamëshirshëm i ka rrënuar. Dëgjoj jehonën e kujës së grave, piskamën e fëmijëve dhe gjëmën e meshkujve.

Në Prizren arrijmë pas njëzet minutash udhëtim përmbi tokë.

Prej mendjes nuk më largohen pamjet e fshatrave të rrënuara dhe jehona e vajtimeve të grave.

Më çojnë në një sallë.

Nuk mund ta marr me mend se çka ishte më parë: sallë apo kasolle e shtazëve - e lopëve.

Është e mbushur me uniforma.

Njëri prej të uniformuarve më thotë se duhet të nënshkruhem në librin e mysafirëve.

Posa e marr lapsin kimik në dorë, që të vë nënshkrimin ku kërkohet, në sy më përplasat kancelari gjerman duke u përshëndetur me Hashim Thaçin. Mbasi nënshkruhem përshëndetet edhe me mua e me të tjerët.

Zëmë vendet.

Karshi kancelarit Shreder ulet Hashimi.

Shrederi është ai që e tregojnë televizionet: as më shumë e as më pak. Ka të veshur një këmishë me mëngë të shkurtra. E unë jam uniformizuar me setër e kravatë!

Sytë e tij janë të mëdhenj e të kaltër: janë përbërësi trupor i tij më identifikues.

E merr fjalën shpejt. Dhe na thotë se kishte dëshirë të takohej me ne për të mësuar ç' mendojmë për perspektivën e zhvillimit të demokracisë në Kosovë dhe të marrëdhënieve, të marrëdhënieve të ndërsjella, e thekson, të partive tona. Kush e di se çka krejt i është thënë prej të huajve dhe prej disa tanëve për këto marrëdhënie.

Nuk e zgjat shumë.

Gjermanët flasin pak po punojnë shumë. E ne e tjerrim shumë muhabetin, gati thashë mut-habetin, dhe punojmë pak!

Edhe pyetjet që bëri, i bëri disi asnjanshëm, disi i çmobilizuar. Mendoj: janë punë të vogla për të këto për të cilat ka ardhur këtu. Më habitën, megjithatë, pyetjet që na bëri: ishin pyetje për çështje të dorës së tretë, për çështje të dorës së tretë në kohën kur do të duhej të pyeste për çështje të dorës së parë mos për Gjermaninë atëherë gjithsesi për Kosovën.

Mbas kancelarit Shreder e mori fjalën Hashimi. I është mbushur mendja Hashimit apo ia kanë mbushur mendjen Hashimit disa nga bashkëpunëtorët se kudo e kurdo duhet ta marrë fjalën i pari nga kosovarët, ta marrë fjalën i pari edhe kur do të ishte më mirë që, si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme, për të huajt imagjinare, që s’ë njuh kush, madje as LDK-ja, ta merrte i fundit, dhe ashtu në fjalën e kryeministrit, t’i nyjëtonte çështjet më të rëndësishme, shpesh keq të shpërndara e keq të tjerra në diskutimet e të tjerëve para tij, sidomos të tjerërta të LDK-së!

Flet për rolin e UÇK-së, për përpjekjet që po bëjmë për normalizimin e jetës, për veprimtarinë politike, për Qeverinë e Përkohshme. Flet gjatë, por jo aq gjatë sa foli atë ditë në mbledhjen e Këshillit Kalimtar të Kosovës në krye me Bernard Kushnerin.

Mbas Hashim Thaçit fjalën e mori Edita Tahiri. Dhe foli për synimet e LDK-së sot, dhe foli siç foli, siç s’duhej, në mbledhjen me Dan Evertsin dhe Knut Volebekun. Dhe, foli prapë për problemin e dy qeverive tona. Prapë mbrojti ish-“institucionet”, që ia mbanin paqen Millosheviqit në Kosovë! Prapë na solli plagë politike. Prapë na e zbriti nivelin e mbledhjes! Bukoshi dhe Rugova nuk e lënë Edita Tahirin e shkretë rehat po e mjelin aq sa mund ta mjelin ata haduma duke e detyruar të blegërojë për “institucionet” e LDK-së nën dhunën e terrorin e regjimit të Millosheviqit, madje edhe para Gerhard Shrederit!

Në fund e mora fjalën unë. Dhe, fola për njëmendësinë e ndryshuar në Kosovë; për rolin e NATO-s e të Gjermanisë në ndryshimin e kësaj njëmendësie; për rolin që mund të luajë Gjermania në rindërtimin e Kosovës. Dhe fola për problemet që na shqetësojnë sot: për sigurinë ende të pasigurt, për ndarjen e Mitrovicës si vatër e destabilizimit të Kosovës, për paritetin 1 serb - 1 shqiptar në punësim si pengesë e demokratizimit të Kosovës, për privatizimet, për rrënimin e institucioneve të kulturës me qëllim cenimin e identitetit të popullit shqiptar. E të tjera.

Mbas fjalës sime kancelari Shreder pyeti, prapë, se si qëndron puna e bashkëpunimit mes partive shqiptare?

Edita Tahiri dhe Hashim Thaçi bënë polemikë.

Hashim Thaçi e ngre çështjen e mjeteve që kanë dhënë shqiptarët në Gjermani - çështjen e tre përqindëshit, që mbahen në bankat gjermane si pronë e Bujar Bukoshit dhe e Kryesisë së LDK-së!

Edita Tahiri iu përgjigj duke ngritur çështjen e Fondit Vendlindja thërret, që e kanë tharë e shterur komandantët e UÇK-së!

Niveli i bisedës bie poshtë, tepër poshtë!

Biseda ndotet!

Ndërhyj: nuk është e nevojshme sot të flitet për “imtësi” të tilla.

Kancelari Shreder e përfundoi takimin me ne duke na falënderuar për pjesëmarrje. Dhe kështu mori fund një takim pothuaj i dështuar, në të cilin ne s’thamë gjithë ç’duhej të thoshim, por thamë edhe çka nuk do të duhej të thoshim!

Kancelari i Gjermanisë e filloi takimin me fjalë për çështje të dorës së tretë dhe e përfundoi edhe më keq: pa thënë çka do të bëjë Gjermania dhe çka do të bëjë Bashkimi Evropian dhe çka do të bëjnë ndërkombëtarët që Kosova të shërohet sa më mirë e sa më shpejt prej plagëve të shumta që ia ka shkaktuar regjimi i Sllobodan Millosheviqit. Mund të jetë se ai ashtu edhe kishte dashur: të parandalonte që të flasim për ato plagë. Megjithëse diçka thamë, por edhe këto që thamë i zhvlerësoi Edita Tahiri duke ringjallur polemikën për politikën e “institucioneve” të nënshtimit, e tre përqindëshit, e të Fondit “Vendlindja thërret” dhe duke na fundosur ashtu në një bërakë ku më së shumti u përloç vetë ajo, por s’e la pa përloçur as Hashim Thaçin!

U kthyem në Prishtinë me helikopter në ora 15:15 minuta.

Në orën 20:00, TVSH, në emisionin për Kosovën, dha lajmin për takimin e Hashim Thaçit me kancelarin gjerman, Gerhard Shreder, dhe për mosardhjen e kryetarit të LDK-së, Ibrahim Rugova, në këtë takim. Gazetari, që kishte bërë lajmin, Bujar Muharremi, na injoroi ne të tjerëve në takimin me kancelarin Shreder si të mos ishim fare as aty as të gjallë! Kjo ishte teknologjia politike dhe

informuese e gazetarit Bujar Muharremi, në mendjen e të cilit ishin salduar primitivizmi dhe stalinizmi!

Dhe kjo alkimi e tij kundërdemokratike ndoshta shprehte edhe dëshirën, mund të ishte edhe kërkesën, e atij që e veçoi si të vetmin subjekt me të cilin duhet të merret televizioni i quajtur TVSH në emisionin për Kosovën: edhe kërkesën e Hashim Thaçit!

## 24.7.1999

Kam vendosur të pushoj sot, të mos dal nga shtëpia dhe të mos thërras kënd.

Jam shumë i lodhur. Prapë kam filluar të vuaj prej lodhjes që mjekët e quajnë kronike.

Nipat dhe mbesat përbëjnë një orkestër shumë të zëshme, shumë simpatike, që sjell kënaqësi në qetësinë time të dëshiruar.

Kjo, ndërkaq, është një orkestër që më përkujton se vetëm me fëmijët shtëpia bëhet çerdhe e kuptimshme jetësore.

Rreth mesditës Televizioni BBC jep lajmin për masakrimin, thotë, të katërbëdhjetë serbëve në një fshat afër Lipjanit. Familjarët e shqiptarëve të masakruar gjatë luftës duket nuk kanë mund të përmbahen e të mos hakmerren tani. Serbët, natyrisht jo të gjithë serbët, kanë bërë aq shumë krime ndaj shqiptarëve sa që do të dukej e panatyrshme që familjarët e gjithë shqiptarëve të masakruar të vetëprivohen prej çdo ndjenje hakmarrëse!

Por, nuk duhet të hakmerremi.

Është mëkat të ndëshkohen hakmarrshëm të pafajshmit, por është mëkat të mos ndëshkohen ligjërisht të fajshmit. Kriminelët serbë, që aq vuajtjen e aq viktimiten na e kanë shkaktuar, duhet t'i zërë dora e drejtësisë e s'po i zë!

Masakra e katërbëdhjetë serbëve mbrëmë nuk flet për trimëri, po për dobësi. Nuk je hakmarrë në kohë lufte, por po hakmerresh nën ombrellën e forcave paqësore ndërkombëtare! Moralisht e palejueshme. Hakmarrjet e këtilla, si kjo e tanishmja,



nuk flasin mirë për ne. Duhet ta dimë se hakmarrjet e tilla, përpos të tjerash, e vështirësojnë edhe pajtimin e ndërkombëtarëve me idenë e pavarësisë dhe të mëvetësisë së Kosovës.

## **25.7.1999**

Gjithë ditën e kaloj në shtëpi, sa në bibliotekë e sa para televizorit. Në një çast Valjeti, i pari prej nipave e mbesave të mia, më pyet:

- Pse, gjysh, nuk po del më të ecësh si përpara?

Nuk dita se si t'i përgjigjem.

Ta gënjeja e dija se nuk duhej.

T'ia thosha të vërtetën do të ishte vrazhdë, jo pedagogjike.

E, e vërteta pse nuk po dilja më si përpara, që të ecja në natyrë, ishte kjo: kisha drojë prej dorës së ndonjë serbi nga Kosova apo të ndonjë serbi nga Serbia që kohë pas kohe provojnë të kalojnë në Kosovë për hakmarrje.

I takoj brezit që do ta kujtojë jetën i ngarkuar shpirtërisht nga dhuna e terrori i regjimeve serbe. Liria ime mund të jetë se do të mbesë përgjithmonë e cenuar nga kjo drojë: nga droja prej shtetit serb, në të vërtetë jugosllav, nga policët, ushtarët dhe zyrtarët e tij.

Në orën 15:00 erdhi përfaqësuesi i OSBE-së në Kosovë, Dan Everts. Erdhi me Visar Rekën. E pritëm mirë, siç i pret gruaja ime Shpresa të gjithë ndërkombëtarët që na vijnë në shtëpi për të biseduar për çështje të Kosovës, për të djeshmen, të sotmen dhe të ardhmen e saj. Mbeti gjatë, deri në orën 18.

Kishte ardhur për të dëgjuar mendimet e mia për një sërë çështjesh e, mbi të gjitha, për mediet dhe rolin e tyre në jetën tonë të sotme politike, shoqërore e kulturore. Do të themelojë Radiotelevizionin publik në gjuhën shqipe, serbe dhe turke. E, më vonë do të lejohen frekuencat edhe për kanale private televizive.

I thashë, përpos të tjerash, se për mediet është e nevojshme të bëhen tri gjëra:

e para, të miratohet ligji i ri i Kosovës për mediet dhe të jetë ky ligj bashkëkohor, më qartë e thënë, ligj modern, ligj i standardeve demokratike perëndimore;

e dyta, të hartohet Kodeksi i gazetarisë në të cilin do të përcaktoheshin kriteret dhe standardet etike të sjelljes dhe punës së gazetarëve; dhe

e treta, të themelohej një shkollë për aftësimin e gazetarëve, që do të përgatiteshin për zbatimin e atij Ligji dhe të atij Kodeksi.

Gazetarët tanë të sotëm janë të formuar në shkollën e në njëmendësinë njëpartiake, të censurës, të monopolizmit njëpartiak, të servilizmit e të deformimeve të tjera.

I pëlqyen shumë këto tri propozime.

Biseduam më tej edhe për jetën politike, për partitë, për Këshillin Kalimtar të Kosovës në krye me Bernard Kushnerin, si dhe për zgjedhjet e ardhshme. Dan Evertsi me këtë rast e gjykoi ashpër e, kjo domethënë drejt, politikën italiane ndaj Kosovës e shqiptarëve dhe manipulimin që Qeveria italiane po bën me kryetarin e manipulueshëm të LDK-së, Ibrahim Rugovën.

Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Dan Evertsi, nuk ngurroi të thotë se edhe Franca luan lojë të dyfishtë në Kosovë. Roli i Gjermanisë në Kosovë, thotë, është shumë i rëndësishëm, por LDK-ja dhe Bujar Bukoshi kanë “punuar” shumë atje, prandaj, gjermanët po sillen pak çuditshëm: po përkrahin udhëheqjen e LDK-së dhe qeverinë e Bukoshit, që i ka shkelur koha kaherë.

- A pajtoheni që të jemi në lidhje të rregullt? - më pyeti në fund të bisedës Dan Evertsi.

- Po si jo, zotëri Everts, - i përgjigjem.

E përcjell deri te xhipi me të cilin ka ardhur. U befasova kur e pashë vozitësin e tij shqiptar, që kishte pritur gati tri orë në xhip. Më erdhi keq pse nuk e dija se ishte aty se, po të dija, do ta merrja brenda, në shtëpi.

Nuk do të lejoja kurrë që vozitësi im të presë me orë të tëra para shtëpisë në të cilën do të isha mysafir a zot shtëpie unë.

**26.7.1999**

Dje kishte ardhur në Prishtinë një delegacion i Partisë Demokratike të Shqipërisë, në krye me sekretarin e saj, Genc Pollo. Gazetat kishin shkruar se do të vijë monarku i asaj Partie, Sali Berisha, por, ja, nuk paska ardhur ai. Mund të jetë që me ardhjen e tij në Kosovë të mos jetë pajtuar shefi i Misionit të OKB-së, Bernard Kushneri.

Sot, rreth orës 10:30 minuta, për të vizituar LBD-në erdhën pesë anëtarë të këtij delegacioni.

I pritëm në sallën shkencore të Institutit Albanologjik, sepse në kabinetin tim nuk do të kishin ku të uleshin rreth dymbëdhjetë vetë: pesë anëtarë të PD-së së Shqipërisë dhe shtatë të LBD-së së Kosovës.

Teksa u ulëm, të gjithë, Genc Pollo e mori fjalën! Nuk më dha afat që, si zot shtëpie, t'u shpreh mirëseardhje i pari, siç është zakoni i vjetër dhe siç është zakoni i ri. Për fat nuk foli gjatë sepse po të fliste më gjatë se ç'foli retorika dhe patosi që shënonin fjalën e tij do të dukeshin në fytyrën time të mërrlur!

Mbasi e kreu fjalën Genc Pollo e mora fjalën unë dhe u dëshirova mirëseardhje dhe shpreha gëzimin pse janë në Institutin Albanologjik, i cili kishte bashkëpunuar dhe bashkëpunon ngushtë me Institutin e Gjuhësisë dhe të Historisë të Tiranës, prej të cilit kemi mësuar shumë për organizimin e punëve në Institutin tonë dhe për hulumtimet kërkimore, shkencore e profesionale. Në vazhdim u foli për gjendjen e sotme dhe për të ardhmen e Kosovës. Konstatimit të Genc Pollos për fitoren tonë më të arritur dhe për ndërtimin e shtetit kosovar iu përgjigja se është kryer vetëm një fazë në përpjekjet për pavarësinë e Kosovës, kurse tani hyjmë në fazën tjetër, në fazën e demokratizimit të shoqërisë kosovare si dhe të përpjekjeve jo të lehta politike dhe diplomatike për arritjen e përkrahjeve ndërkombëtare për krijimin e shtetit të Kosovës. Do t'i kalojmë më lehtë pengesat e ndryshme, që do të na dalin përpara, në qoftë se do të jemi më të bashkuar se ç'jemi

tani, në qoftë se do të punojmë së bashku këtu, në Kosovë, dhe në Shqipëri.

Mandej e mori fjalën edhe një anëtar i delegacionit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, ish-profesor i teorisë së letërsisë në Universitetin e Tiranës, i cili, mbasi u krye takimi, duke dalë prej Institutit, do të më thotë se i ka lexuar të gjitha veprat e mia dhe se në tezën e doktoraturës më ka cituar shumë herë.

Mbas tij folën edhe Hydajet Hyseni, Jonuz Salihu, Daut Maloku dhe Bajram Kosumi.

Në fund, kur po lamtumirehim, mbasi tha se i pëlqente shumë godina e Institutit, i tregova Genc Pollos se babai i tij kishte qenë në këtë Institut. M'u përgjigj shkurt me një: po! Dhe m'u përgjigj kështu shkurt ose pse s'dëshironte ta shihnin kolegët në bisedë të veçantë, më të gjatë me kritikun e pamëshirshëm të kryetarit të PD-së, Sali Berisha, ose pse nxitonte në takimin tjetër që e priste delegacionin.

Mbasi shkoi delegacioni i Partisë Demokratike të Shqipërisë, në Institut erdhën edhe pesë veta prej Tiranës e Kukësit. I shoqëronte një oficer i UÇK-së. Më thanë se ishin anëtarë të djeshëm e dy prej tyre edhe të sotëm të SHIK-ut. Nuk qëndruan gjatë në Institut.

- Dëshëm vetëm të shihemi me ju, - thanë. - U vonuam, - thanë, - sepse nuk deshëm të takoheshim me delegacionin e PD-së.

Sigurisht kanë arsye pse nuk kanë dashur të shihen me ta.

## **27.7.1999**

Në orën 10:00 u takova, në Institutin Albanologjik, me përfaqësuesin e Departamentit Amerikan të Shtetit që tha se quhej Gregori Kraford.

Donte të dinte çdo gjë për LBD-në.

Donte të dinte a ka marrë pjesë LBD-ja në UÇK.

Donte të dinte nëse ishte pjesëtar i UÇK ndonjëri nga anëtarët e Kryesisë së LBD-së.

Donte të dinte çfarë programi politik ka LBD-ja.

Donte të dinte çfarë qëndrimesh ka LBD-ja ndaj LDK-së dhe udhëheqjes së saj.

Shkurt e shqip e thënë: ky, si tha, përfaqësues i Departamentit Amerikan të Shtetit, kishte ardhur të më testonte. Testimet që po më bëhen mua dhe krejt LBD-së prej diplomatëve janë fryt i intrigave dhe gënjeshtrove që LDK-ja kurdis për LBD-në e UÇK-në, për marrëdhëniet midis tyre dhe për qëndrimet e tyre ndaj LDK-së e satelitëve të saj partiakë. Vetëm një të vërtetë e thonë udhëheqësit e LDK-së për LBD-në dhe UÇK-në: se nuk ka dallime politike mes tyre ose, si e thonë ndonjëherë, se UÇK-ja dhe LBD-ja në të vërtetë janë një. Dhe këto pohime LDK-ja i përhap ndër ndërkombëtarët, përpos të tjerash, me qëllim që në Misionin e OKB-së në Kosovë anëtarë të LBD-së dhe UÇK-së të ketë jo sa ka tani - dyfish më shumë se ç'ka LDK-ja, po të ketë vetëm sa ka ajo -LDK-ja!

Pas këtij diplomati amerikan, me Shemsi Reçicën erdhi një gazetar grek, të cilit përmes Shemsiut i kisha premtuar intervistë për gazetën *Elefterotipia*.

Biseduam gjatë.

Si shumica e gazetarëve të huaj, ishte mjaft provokues.

Bëra luftë politike me të.

Ishte aspak fshehtë proserb e kjo do të thotë se ishte kundërshqiptar.

Qe dy ditë nuk kemi ujë në shtëpi.

Mbeturinat e autobombës së shpërthyer para shtëpisë sime, më 26 mars, ende qëndrojnë në vendin e shpërthimit pa i prekur kush. Nuk ka kush t'i heqë! Shefi i Misionit të OSBE-së, Dan Everts, më ka thënë se do të bisedojë me ata të KFOR-it që t'i heqin, por ende nuk ka ardhur kush prej tyre. Evropianët i kryejnë mirë e shpejt punët e veta, po nuk nxitojnë t'i kryejnë punët tona. Dhe,

pse t'i kryejnë? Ata janë këtu të sundojnë dhe të na thonë çka duhet të bëjmë ne për veten tonë.

### **28.7.1999**

Lexoj romanin e shkrimtarit të vjetër francez, Piere de Marivo, *Jeta e Marianës*. E veçanta e realizmit të tij jashtëzakonisht të thjeshtësuar është përimtimi i ndjenjave të protagonistes. Mund të jetë se ky autor dhe romani i tij në fjalë janë çmuar shumë prej sentimentalistëve dhe kanë ndikuar në krijimtarinë e tyre.

### **29.7.1999**

E enjte.

Ditë e mirë verore për ata që e durojnë vapën.

Në mëngjes, në shtëpi, erdhi Hydajeti, Hydajet Hyseni, dhe më tha se në orën 11:20 minuta, pra në 11:20 e jo në 11:30 minuta duhet të takohemi me sekretaren e shtetit, zonjën Medlin Olbrajt.

Pak para orës 11 shkova në zyrat e Qeverisë së Përkohshme.

Duke shkuar Hydajeti më thotë se në takim nuk do të shkojmë bashkë me anëtarë të tjerë të LBD-së dhe me përfaqësuesit e UÇK-së, sepse ne do shkojmë veç dhe ata veç!

Nuk kuptoj çka ka ndodhur: pse janë caktuar takimet veç e veç e pse s'është caktuar, si herë të tjera, takim i përbashkët me të gjithë ne përnjëherë. Nuk e di as unë ç'ka ndodhur, thotë Hydajeti.

Shkuam në ndërtesën ku është i vendosur Misioni i OKB-së.

Këta të misionit të OKB-së na thanë se unë dhe Hydajeti do të takohemi me zonjën Olbrajt bashkë me përfaqësuesit e UÇK-së.

Por, megjithatë, regjia e takimit është ndryshuar.

Nuk e kuptova refuzimin e zonjës Medlin Olbrajt që të takohet me ne veç e veç ashtu siç s'e kuptova as refuzimin e atyre të UÇK-së që të shkonim bashkë në takim!

Kërkoj veturë të dal prej kësaj ndërtese: nuk e pranoj sjelljen fyese të Zonjës Medlin Olbrajt të kurditur prej fukarenjve tanë të cilët autoritetin e vet të munguar duan ta kompensojnë me takim “origjinal”, të veçantë, me përfaqësuesen e lartë amerikane.

- Ti po deshe rri, po deshe hajde me mua, - i thashë Hydajetit.

- Do të vij edhe unë me ty, - u përgjigj Hydajeti.

Nuk gjejmë veturë.

Derisa po kërkoja mundësinë të dilnim prej ndërtesës, na afrohet një nëpunës i Zonjës Olbrajt dhe na ftoi në takim me të.

Shkova me përtesë e me pendesë.

Pas nesh, në zyrën ku do të takoheshim, erdhi ajo, zonja Medlin Olbrajt.

Duket më mirë se në Rambuje para shtatë muajsh dhe se në Këln para dy muajsh.

Përsëndetemi me puthje në faqe.

Nuk ma merr mendja se Sekretarja e Shtetit, domethënë ministrja e Jashtme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duhet t’i puthë në faqe ata me të cilët takohet ashtu siç nuk ma merr mendja se ajo duhet të lejojë që të puthet në faqe prej atyre me të cilët do të takohet!

Por, ç’t’i bësh, shprehitë mund të bëhen zakone e zakonet shprehi!

Posa ulemi e merr fjalën ajo dhe thotë se nuk e kemi përmbushur premtimin për bashkimin e forcave tona politike dhe për paraqitje të njësuar rreth problemeve tona. Nuk kuptova nëse këto fjalë të saj ishin qortim i veçantë për LBD-në dhe mua apo për ndonjë parti tjetër apo për të gjitha!

Me mendimet e tjera që thotë herë e zbut e herë e forcon “fajin” tonë pse në Qeverinë e Përkohshme e në Këshillin Kalimtar nuk është edhe kryetari i LDK-së, Ibrahim Rugova.

Prej gjithë atyre që tha Zonja Medlin Olbrajt në kujtesë më gjatë më mbeti mendimi i saj i mençur, që thotë shumë, që është qortim e këshillë për ne.

- S’kemi fituar në luftë për të humbur në paqe!

Nuk ka dyshim se kjo fjali e Zonjës Olbrajt përmbante shqetësimin e saj dhe të ndërkombëtarëve në Kosovë në përgjithësi për shkak të vrasjes së katërmëdhjetë serbëve afër Lipjanit para disa ditësh, si dhe të dëmtimit të disa monumenteve të tyre fetare. Mund të jetë se ky mendim përmbante shqetësimin e saj edhe për disa sjellje tonat të ndërsjella, sidomos mes LDK-së dhe UÇK-së. Zonja Olbrajt dhe ndërkombëtarët e tjerë në Kosovë mund të ishin të bindur se me rënien e autoritetit politik të udhëheqjes së LDK-së në politikën kosovare tani, pas luftës, do të kenë shqetësime të shpeshta për shkak të sjelljeve të shqiptarëve ndaj serbëve.

E marr fjalën me përtesë dhe, e marr fjalën me përtesë, sepse Zonjës Olbrajt përtoja t'i thosha çka ishte e nevojshme t'i thosha.

- Faji pse forcat tona politike, mjerisht, nuk po bashkëpunojnë si duhet e sa duhet nuk qëndron te Lëvizja e Bashkuar Demokratike e as tek UÇK-ja, por tek udhëheqja e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në Rambuje jemi marrë vesh, të gjithë, të tri forcat politike -UÇK-ja, LDK-ja dhe LBD-ja, për krijimin e Qeverisë së Përkohshme, por udhëheqja e LDK-së nuk po e respekton këtë marrëveshje! Dhe, nuk po e respekton sepse nuk është e liruar prej iluzionit se në Kosovën e sotme duhet të ushtrojë rolin që e ushtronte në kohën e Sllobodan Millosheviqit dhe me pajtimin e tij. Ka kaluar ajo kohë. Kosova e sotme është Kosovë tjetër. Duart e Millosheviqit dhe të Serbisë s'mund të mbërrijnë më në Kosovë dhe s'mund të mbërrijnë sepse s'i lejon as SHBA-ja.

Zonja Medlin Olbrajt tund kokën pajtueshëm me këto fjalë të miat.

Pas meje e merr fjalën edhe Hydajeti.

Foli shkurt, por më mirë se unë. Shprehu besimin se forcat tona politike po vijnë duke u vetëdijesuar jo vetëm për rëndësinë, por edhe për domosdonë e bashkëpunimit dhe të paraqitjeve të tyre me mendime e veprime të njësuara.

Në fund rishtazi e mori fjalën Zonja Olbrajt. Prej fjalëve që tha u pa se përshtypja e saj për bisedën me ne ishte e mirë.



Kur bëmë të lamtumiremi ia dhurova romanin *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, të përkthyer frëngjisht, natyrisht me përkushtim. Duke e marrë ma zgjati dorën për urim dhe më tha se lexon frëngjisht.

Në mbrëmje, në ditarin e orës 20:00, TVSH-ja tha se Sekretarja e Shtetit e SHBA-së, Zonja Medlin Olbrajt, u takua sot në Prishtinë me kryetarin e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, Hashim Thaçin dhe me përfaqësuesit e LDK-së, Naim Jerliu dhe XY.

Takimi i Zonjës Medlin Olbrajt me Rexhep Qosjen dhe Hydajet Hysenin u hesht. Duart e zeza të kujt punojnë në mënyrë aq fashiste, të pamoralshme, të poshtër, në RTSH? Duart e Sali Berishës? Duart e Ibrahim Rugovës? Duart e Bujar Bukoshit? Duart e të treve? Apo edhe duart e kujt s' duam të besojmë unë e Hydajeti.

Duan të mënjanojnë prej skenës politike të Kosovës ish të burgosurit politikë dhe intelektualët e mbledhur në LBD me shpresë se ashtu do të arrijnë të mënjanojnë edhe ata të UÇK-së? Duan të mënjanojnë forcat e dëshmuara atdhetare me shpresë se në skenën politike do të mbesin vetëm forcat ish-komuniste: vetëm lëdëkistët, socialdemokratët dhe liberalët, të cilëve ndërkombëtarët, që ende nuk pranojnë idenë e pavarësisë së Kosovës, ua dredhin qafën kur të duan dhe si të duan, siç ua dridhte, pa farë mudi, Sllobodan Millosheviqi!

### **30.7.1999**

E premte.

Jam në takim me një përfaqësues të zyrës gjermane që do të hapet shpejt në Prishtinë. Biseduam për çështjet që te ne po bluhen për ditë, prej mëngjesit e deri në mbrëmje. Më pyet:

- Mjetet financiare që janë mbledhur prej shqiptarëve në Evropë, kush i disponon?

- Ky është një problem për të cilin nuk di gjë të sigurt, - i përgjigjem.

- Ndoshta i disponon Qeveria e Bukoshit, thotë?

- Nuk e di, - i përgjigjem.

- I kërkon Qeveria e Thaçit? - pyet.

- S' di ç'të them! Herë i kërkon e herë s'i kërkon!

- A mund t'i kërkojë edhe Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara? - Pyet.

- Është qeveri e Kosovës sot, - i përgjigjem duke qeshur.

Heshtje.

Lëmshit tonë politik, si po shihet, i është shtuar edhe lëmshi financiar!

Mbas përfaqësuesit të Zyrës së ardhshme gjermane në Prishtinë, vjen një amerikan, të cilit nuk ia mbajta mend emrin. Kërkon mendimin tim për takime intelektuale mes amerikanëve, shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës në SHBA.

I përgjigjem:

- Tani në Kosovë janë Misioni i OSBE-së dhe Misioni i OKB-së dhe nuk ka nevojë për takime, biseda a bisedime politike për Kosovën mes intelektualëve amerikanë, shqiptarë e serbë, që nuk zgjidhin asgjë. Kosova është e përfaqësuar prej Këshillit Kalimtar të Kosovës në krye me përfaqësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Bernard Kushner, dhe prej shqiptarëve që bëjnë pjesë në këtë Këshill si përfaqësues të forcave tona politike.

Mandej erdhi Din Mehmeti. S'e kam parë që sa kohë.

Është plakur shumë.

I dridhen duart.

Ma tregon dramën e tij e të gruas së tij, që mund të bëhej tragjedi gjatë pastrimeve etnike që kryen forcat serbe.

- Na ka shpëtuar i madhi Zot si shumëkënd, - thotë.

- Por, shumëkënd s'e ka shpëtuar, - them.

- Mjerisht jo, - thotë.

Pas Dinit vijnë Hydajet Hyseni dhe Sherif Konjufca.

Bisedojmë për punën e LBD-së.

Hydajeti është i interesuar për bashkim me partitë e majta - Lëvizjen Popullore të Kosovës, tani e quajtur PBD, me LKÇK-në dhe me partinë që do të krijojë Hashim Thaçi.

Domethënë: Hydajet Hyseni është i interesuar për rrëgjimin e forcave tona politike, numri i të cilave është rritur kohëve të fundit, në dy forca politike. Nuk i shkon mendja se ashtu zvogëlohet numri i forcave politike që mbahen me UÇK-në dhe partitë që do të bëhen prej saj, ndërsa shtohen forcat e bëra prej Lidhjes Komuniste në krye me LDK-në.

Bisedën na e ndërpret Jahir Ahmeti, i cili më njofton se po më kërkon Luan Omari me disa anëtarë të tjerë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Për t'u takuar me ta vijnë edhe Hydajeti dhe Sherifi. Ishin Luani, Donika Omari, Fahredin Hoxha, Loreta Xhemalaj dhe vozitësi i tyre.

I thirra në shtëpi.

- Do të vijmë të shtunën pasi të kemi parë, - tha Luani, Kosovën e rrënuar.

Në mbrëmje, në shtëpi, erdhën, bashkë me Musa Limanin, pesë kolegë-profesorë të Universitetit të Tiranës, mes të cilëve ishte edhe Genc Ruli. Të gjithë, me përjashtim të Gencit, ishin anëtarë të Partisë Socialdemokrate.

Bisedojmë gjatë e më së shumti për kryetarin e Partisë Demokratike, Sali Berishën, i cili pa pushuar po shkaktonte tollovi në Shqipëri. Genc Ruli e njeh mirë, shumë mirë, thotë, Sali Berishën, sepse kanë punuar bashkë në fillimet e pluralizmit. Vërej se Genci i nënçmon gjasat e Partisë Demokratike në zgjedhjet e ardhme, madje, në të gjitha zgjedhjet e ardhshme.

Nuk më duket se ka të drejtë. Për Partinë Demokratike do të votojnë jo vetëm ata që e kanë urreyer komunizmin, por edhe një numër i atyre që ishin të privilegjuar në atë kohë, por tani bëhen se ishin të përndjekur nga komunistët.

Të gjithë shqiptarët janë sot pamatshëm të politizuar.

Flasin vetëm për politikë. Dhe, gati të gjithë paraqiten të përndjekur!

Politika është alfa dhe omega e qenies sonë sot.  
Në Shqipërinë shtetërore edhe më shumë se në Kosovë.  
Ata të cilëve më pak a më shumë iu mungojnë të tjerat gjejnë  
ngushëllim, natyrisht të rrejshëm, në politikë.  
Medet për ta!

### **31.7.1999**

Gjithë ditën e kalova në shtëpi.

Violla me Vesën e Lekën na e gëzoi shtëpinë. Ishin pesë ditë  
te Dita dhe Duli.

I shkrova një letër drejtorit të TVSH-së si reagim ndaj emisioneve  
informative të orës 23:00 të datës 29 korrik, në të cilat, në  
informatat për takimet e kancelarit gjerman, Gerhard Shreder, dhe  
të Sekretares së Shtetit, Medlin Olbrajt, me përfaqësuesit e forcave  
politike shqiptare, janë hequr emri im dhe i Hydajet Hysenit.

Në mbrëmje, rreth orës 20:30 minuta, erdhën Luan Omari,  
Donika Omari, Farudin Hoxha, Loreta Xhemalaj dhe vozitësi i  
tyre, Astriti. Shpresa ime ka bërë përgatitjet për pritjen e tyre sa  
më të mirë, sa më të pasur.

Posa u ulën treguan se si u është dukur Kosova pas luftës. Ishin  
shumë të pikëlluar.

E kaluam kohën, deri vonë, në bisedë për politikën që po  
bëhet në Kosovë dhe për politikën e të tjerëve, sidomos, të  
ndërkombëtarëve ndaj Kosovës. Luani Omari është vlerësues  
realist i dukurive, i veprimeve e i mendimeve politike, por është  
më pak kritik se unë. Si jurist dhe si intelektual me shumë përvojë  
ai di t'i gjykojë ato -dukuritë, veprimet dhe mendimet politike,  
më mençur se unë për të tanishmen, por kjo nuk do të thotë edhe  
për të ardhmen. Pavarësinë e Kosovës, si shumë intelektualë të  
tjerë, e sheh si mundësi pak a shumë të largët.

- Do të duhej, pa humbur kohë, të ndërtojmë strategjinë  
kombëtare për pavarësinë e Kosovës, - i them.

Duhet të shikojmë e të bëjmë integrim sa më të fortë ekonomik e tregtar, kulturor dhe pse jo politik, që do të sjellë integrim kombëtar, të kurorëzuar më pas, në të ardhmen, me bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

Për këto arsye duhet së pari të fillojë ndërtimi i rrugës kombëtare Durrës-Tiranë-Kukës-Prizren e, mandej, pa u vonuar shumë, ndërtimi i hekurudhës Tiranë-Kukës-Prizren-Prishtinë. Ndërtimi i saj, i hekurudhës, e frymëzon dhe e lehtëson bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

Në qoftë se e lëshojmë këtë gjasë të tanishme për integrimet, e kjo do të thotë për bashkimin kombëtar, gjasa tjetër, e re, kush e di se kur do të na krijohet.

I luta të qëndrojnë edhe nesër mysafirë të mi.

Nuk pranuan, sepse nesër, në orën shtatë të mëngjesit, udhëtojnë për në Shkup.

## **1.8.1999**

Para Fakultetit Filologjik janë mbledhur shumë studentë, pedagogë dhe qytetarë për të shënuar fillimin e vitit të ri shkollor, përkatësisht vazhdimin e vitit shkollor, që e këputi lufta në të cilën Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-ja nuk lejuan që regjimi i Slllobodan Millosheviqit, përmes spastrimit etnik, ta shpopullojë Kosovën prej shqiptarëve! Në fytyrat e tyre, megjithatë, nuk ka sa do të duhej gëzim. E, si të ketë?

Shumë prej tyre vuajnë për ndonjë a më shumë familjarë pa të cilët i ka lënë lufta.

Më pikëllon shumë, pambarimisht shumë, dhembja e paskajshme e atyre që kanë mbetur pa më të dashurit e tyre, numri i të cilëve është i madh, më i madh se ç'ka mundur kush të mendojë. Për një kohë aq të shkurtër, për shtatëdhjetë e nëntë ditë, aq shumë të vrarë e aq shumë të masakruar: djem, burra, pleq, vajza e gra.

Nuk ka dënim që mund të jetë i mjaftueshëm për shkaktarët e atyre krimeve.

Në orën 15:00 u takova me Bardhyl Mahmutin.

Është kryetar i BBD-së.

E filloi bisedën me retorikë dhe besim të tepruar në partinë e tij.

Tha se me “militarizëm” do t’i fitojnë zgjedhjet.

I thashë se me militarizëm, pas luftës së Kosovës, vështirë fitohen zgjedhje. I thashë se tani nuk jemi më në ilegalitet.

Nuk e kundërshtova, por as nuk e pohova, propozimin e tij për takim njëherë në javë.

Entuziazmi është virtyt i rëndësishëm në jetën e njeriut, por entuziazmi i tepruar mund të jetë i dëmshëm, sepse është prodhues i naiviteteve.

### 3.8.1999

Në hyrje të Institutit, të Institutit Albanologjik, ishte tollovi e madhe: shpërndahen ndihma të sjella nga një shoqatë greke.

Qe ku janë katandisur si mos më keq shumë nga intelektualët tanë: të papunë, pranojnë të marrin ndihma humanitare!

Në orën 11:30 minuta duhet të takohem me shefin e Misionit Amerikan në Kosovë, Lari Rosin. U vonua një gjysmë ore.

Kur erdhi, erdhi si të mos ishte vonuar fare: amerikanëve u lejohen e u falen të gjitha prej të gjithëve.

Pa u ulur mirë filloi bisedën. E interesonte përshtypja ime për takimin me Sekretaren e Shtetit, Zonjën Medlin Olbrajt.

I thashë se në takimin me të m’u krijua bindja se ajo ishte e interesuar që forcat tona politike të rrëgjohen në dy forca. I thashë asaj e po ju them edhe juve se një rrëgjim i tillë i forcave politike në dy forca njëkohësisht i rrëgjon mundësitë tona për ndërtimin e institucioneve demokratike e kjo do të thotë zhvillimin e demokracisë në Kosovë. Këtu nuk është Amerikë ku partitë mezi duken dhe duken kryesisht vetëm kur janë zgjedhjet; këtu partitë,

partitë më shumë se institucionet shtetërore, janë e gjithë politika; këtu partitë e ndajnë popullin në dy anë, prandaj në qoftë se do të mbesin vetëm dy forca politike ato do të sjellin konflikte të rënda në Kosovë, siç sollën në Shqipëri në vitin 1997.

Lari Rosi u pajtua me mendimet e mia sa i përket rrëgjimit të forcave politike në dy parti.

I thashë më tej se përpjekja për zgjidhjen e çështjes së UÇK-së përmes shndërrimit të saj në parti politike është, sipas mendimit tim, e gabueshme. Ushtria askund në botë nuk kthehet në parti. Ushtria s'është e kësaj a e asaj partie, ushtria është organizim jopartiak dhe e tillë, jopartiake, ishte edhe Ushtria jonë Çlirimtare. Ta bësh tani parti do të thotë ta asgjësosh. Kush e merr këtë përgjegjësi!

Lari Rosin nuk u pajtua me këto mendime të miat. Ai e lejon formimin edhe të një partie prej UÇK-së sepse prej saj, thotë ai, janë krijuar dy deri tani: PDK-ja dhe LKÇK-ja.

Mendoj: çka do të mbesë prej UÇK-së në qoftë se krijohet edhe një parti prej saj? Do të mbesë emri pa përmbajtje.

Në fund të bisedës Lari Rosin më ftoi që në shtator të shkoj në Amerikë për vizitë në Institutin Amerikan për Paqe, ku do të njihesha me çështje të ndryshme të organizimit dhe të veprimtarisë partiake demokratike.

Ftesa në të vërtetë ishte qortim i sofistikuar ndaj kundërshtimit tim për kthimin e UÇK-së në disa parti politike e kjo do të thoshte ishte qortim ndaj mospajtitimit tim me asgjësimin e UÇK-së si forcë mbrojtëse e shtetit të Kosovës. E ndërkombëtarët, duke përfshirë këtu edhe SHBA-në, kurrë s'e kishin shikuar plotësisht pajtueshëm UÇK-në.

#### **4.8.1999**

Me Ramiz Lladrovcin, Sadri Fetiun, Jahir Ahmetin, Rrustem Berishën dhe Visar Rekën shkuaam në Drenicë.

Së pari shkuam në Prekaz në shtëpinë e Rifat Jasharit, i cili e kishte hapur të pamen që më shumë se një muaj. Vizituam varret e familjes Jashari, të dëshmorëve të rënë të njëjtën natë në luftë me policinë e përbindshme serbe. Meqenëse nuk gjeta lule në Prishtinë, mora disa lule në oborrin e Institutit Albanologjik dhe i vura në varrin e Adem Jasharit. Mandej shkuam në shtëpi. Aty gjetëm Bacën, Adem Demaçin, një grup veteranësh nga Tropoja, gazetarin anglez, Pol Vud, dhe disa vendës.

Baca Adem ishte duke folur.

Mbasi u ulëm, e lutëm ta vazhdonte fjalën.

E vazhdoi, por jo gjatë.

Mandej, pas kërkesës që m'u bë, e mora fjalën unë.

- Kemi ardhur, iu drejtova Rifat Jasharit, t'ju shohim e t'ju shprehim ngushëllime për humbjen e gjithë atyre anëtarëve të familjes suaj në luftë me pushtuesit serbë. Njëkohësisht kemi ardhur që t'i shprehim nderim të përjetshëm Adem Jasharit, që e ka filluar qëndresën tonë kundër pushtuesve serbë. Adem Jashari është fytyrë historike. Edhe familja juaj sot është familje historike - familje që ka luftuar kundër një ushtrie dhe në atë luftë brenda një nate ka dhënë 22 anëtarë të saj.

Këtu, në këtë vend, do të vijnë gjithmonë shqiptarët që t'i falen emrit të Adem Jasharit dhe Familjes Jasharaj - ashtu siç falemi para përmendoreve të Skënderbeut e të Ismail Qemalit. Ju keni bërë çka s'ka bërë kush: keni luftuar kundër një ushtrie të një shteti pushtues. Ju, kështu, jeni bërë çka s'ka arritur të bëhet asnjë familje evropiane: Familje hero, Familje histori. Ju e keni nderuar popullin shqiptar dhe populli shqiptar do t'i falet emrit tuaj gjithmonë. Unë me këta kolegët e mi e bëmë këtë sot.

Mandej u fol për mundësitë që shtëpia e rrënuar dhe e djegur e Familjes Jasharaj të bëhet kompleks i mbrojtur - memorial. Për këtë propozim më së gjati foli Baca Adem.

Në fund u nënshkruam në fletoren e vizitorëve.



Prej Familjes së Jasharajve shkuam për ngushëllim te Familja e Ilaz Kodrës, po ashtu, në Prekaz, i cili ishte vrarë pak para përfundimit të luftës.

Mandej shkuam te prindërit e Fehmi Lladrovci. Më parë shkuam te varret e Fehmiut, të shoqes së tij, Xhevës dhe të Fatimes, Fatime Hetemit, vajzës njëzetedyjeçare, që kishte rënë në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin vend ku edhe Fehmiu me Xhevën. Vumë lule në varret e tyre.

Në shtëpinë e Lladrovëve gjetëm babanë, nënën dhe gruan e Ramizit me katër fëmijë. Kishte edhe anëtarë të tjerë të familjes. Shtëpia e Lladrovëve ishte përplot fëmijë. Nuk na lëshuan pa drekë.

Prej te familja Lladrovci shkuam për pamje te familja Muçolli. Edhe kjo familje hyn ndër familjet që ka pësuar tragjedi shumë, shumë të rëndë gjatë luftës. Kriminelët serbë i kanë masakruar e, pastaj, i kanë djegur dyzet e katër anëtarë të kësaj familjeje - të katër vëllezërve të kësaj familje: tre vëllezërit, gratë, nusët, vajzat dhe fëmijët. Kanë shpëtuar djemtë që ishin në UÇK, një çupëz katërvjeçare, një vajzë gjashtëmbëdhjetëvjeçare, që kishte marrë tre plumba në këmbë dhe një nuse, rëndë e plagosur. Këtu kishin gjetur vdekjen edhe njëzet të tjerë: shkrimtari Ymer Elshani me të katër djemtë, me gruan e me nënën, një bijë e familjes Muçolli me tre fëmijë, e cila atë natë kishte ardhur me shpresë se këtu do të jetë më e sigurt se në fshatin e të shoqit.

Pamë dhomat e bëra shkumb, në të cilat kriminelët kishin hedhur bombat e tyre! Pamë vatrën në të cilën ishte djegur trupi i Ymer Elshanit dhe trupat e disa të tjerëve! Pamë prerëset e thonjve, unazat e djegura me gishtërinjtë dhe eshtra grash të djegura! Eshtrat ishin të lehtë si sfungjerë! Pamë pusin në fundin e të cilit, në ujë, ishin hedhur: gjysma e trupit të Ymer Elshanit dhe trupat e të tjerëve të djegur bashkë me trupin e tij, që i kishim parë aty, në pus, herën e parë para një muaji, kur kisha qenë te familjet Jasharaj, Kodra, Lladrovci dhe Muçolli, ku jam edhe sot, me Ramiz Lladrovcin.

Pamja ishte më shumë se tragjike, pamje e vepër monsturoze e monstrave serbë në uniforma.

Në të dalë nga rrethi i shtëpive të djegura të familjes Muçolli pamë burrin të cilit serbët ia kishin masakruar gruan me katër fëmijë. Ishte bërë mumie: nuk i lëviznin fare muskujt e dylltë të fytyrës. Sytë e tij shikonin pacaktueshëm, si në shkretëtirë! Ishin sy përplot vuajtje, përplot frikë, përplot trishtim. Ishin sy të humbur në gjithësinë e pakuptimtë për të dhe për mua që u përpoqa sadopak të depërtoj në humnerën e trishtimit të tij.

Në fytyrën e këtij burri lexova mendimet e shprehura shkurt: çka më duhet jeta mua!

Pamjen e këtij njeriu tragjik e mora me vete, në mendjen time, në imagjinatën time, në kujtesën time për ta kujtuar sa herë do të mendoj se mund të pres vdekjen i lumtur e në të vërtetë i mëkatshëm pse kam jetuar deri në moshën në të cilën do të jem!

Tragjeditë njerëzore kanë përmasa të ndryshme, ndërsa kjo që pamë dhe për të cilën mësuam këtu i ka përmasat më të mëdha e më të trishtueshme.

Do të duhej të bëhej film artistik për këtë tragjedi - film i jashtëzakonshëm artistik. Do të mund ta bëja skenarin; do të doja ta bëja skenarin.

Do të shkruaj roman ose Ditar të vëllimshëm për dramën e madhe historike që kemi përjetuar pas 24 marsit 1999. A do të kem jetë e shëndet të mjaftueshëm për ta shkruar.

Kur u ktheva prej Drenicës, rreth orës 18, gjeta në shtëpi Artanin, Artan Venharin, me një oficer anglez, i cili do të bisedojmë për gjendjen politike dhe të sigurisë së Kosovës, natyrisht mbasi të m'i thotë disa mendime të vetat për Kosovën gjatë luftës dhe tani pas luftës.

Flet, së pari, për moskuptimin që po përhapet mes shqiptarëve ndaj Misionit Ndërkombëtar në Kosovë.

- Jeni duke bërë gabime me sjellje e me politikë, - thotë.

Jeni duke humbur simpatinë që kishit fituar, - thotë.

Perëndimi s'është i gatshëm të kuptojë rivalitetin e liderëve shqiptarë, - thotë.

Perëndimi s'është i gatshëm të pajtohet me tiraninë e shqiptarëve pas tiranisë së Millosheviqit, - thotë.

Perëndimi s'e duron turrin e korrupsionit në Kosovë, - thotë.

Nuk kam argumente për mbrojtje.

Oficeri anglez, pa ngurrim, pa dyfytyrësi, në të vërtetë pa shumëfytyrësinë tonë, tha disa të vërteta.

Marrëzitë tona s'kanë fund.

Ndyrësitë dhe ndotësitë mendore, ndjenjore të të turrurve në politikë po bëhen shumë komprometuese për ne.

S'është e lehtë t'u ndalet turri!

Po kalon muaji i mjaltit mes nesh dhe Misionit Ndërkombëtar.

U përgjigjem qortimeve të tij të drejta e të sinqerta duke i zvogëluar sadopak të këqijat tona. Dhe, kështu, u tregova dyfytyrësh edhe unë.

## **5.8.1999**

Me NATO-n na ka ardhur siguria jetësore.

Me NATO-n na ka ardhur besimi në ardhmërinë e Kosovës së lirë e të pavarur.

Por, NATO nuk është krijuar për ne, për shqiptarët.

NATO është krijuar për të mëdhenjtë, për të fortët, që të jenë më të mëdhenj dhe më të fortë.

Për fat, interesat tona historike u përputhën me interesat gjeostrategjike të krijuesve të NATO-s.

Me protektoratin e vendosur këtu prej OKB-së e kjo do të thotë edhe me personelin e tij do të na vijjë, përpos të mirave, edhe të këqija: si droga, prostitucioni dhe, ndoshta, sida.

Violeta Allmuça, shkrimtarja dhe gazetarja me dhunti krijuese, e cila qe katër ditë është në Prishtinë, më tregon se në Hotelin e quajtur Grand, ka takuar disa bosë të drogës!

Tragjeditë që sjell droga do të shtohen kur ata bosë t'i njohin e t'i gllabërojnë adoleshentët, në përgjithësi të rinjtë e të rejat.

### 7.8.1999

S'kemi ujë!

S'kishim as pardje!

S'kishim as dje!

Ndoshta s'do të kemi as nesër!

S'kemi rrymë!

S'kemi siguri, kurrfarë sigurie jetësore.

Gjendjet e pasluftës gjithmonë dhe gjithkund janë gjendje të rënda.

Në orën 8:00 vjen Mehmeti, Mehmet Hajrizi, me veturë: do të shkojmë në takim me zëvendësin e administratorit Bernard Kushner, me amerikanin Xhon Kovi.

- S'është në zyrë, - na u tha kur mbërritëm!

U befasuam.

U befasua sidomos Hydajeti, që ishte marrë vesh me të për kohën e takimit.

Pas pesëmbëdhjetë minutash pritjeje u kthyem nga kishim ardhur. Posa u larguam 20-25 metra, amerikani Xhon Kovi u pa duke vrapuar për të na zënë.

Kërkoi falje.

Kërkoi falje dhe na tha se takimi ishte caktuar për orën 11:00.

Deri tash kishte qenë në një mbledhje tjetër.

Nuk u befasuam: Hydajeti shumë shpesh i huq orët e takimeve.

Është poet i shpërqendruar.

Nuk e shpëtojnë prej pasojave të shpërqendrimin as lapsat e as fletoret!

Në orën 11:00 u vonuam ne pesë minuta. Pa dashje.

Xhon Kovi donte të dinte më shumë se ç'kishte dëgjuar për LBD-në.

Ia plotësojmë dëshirën.

I tregojmë se ende nuk kemi as zyrë, as mjete për punë.

Na flet pyetshëm për zgjedhjet e ardhshme, që do të mbahen para një viti.

Na tregon se Bernard Kushneri e ka shtuar Këshillin Kalimtar edhe me një anëtar të bllokut të LDK-së, mund të jetë me dikë të demokrishterëve.

Nuk mund të kundërshtohet ky shtim i njërit bllok me një anëtar më shumë se ç'kanë dy blloqet e tjera pikërisht pse i shtuari është i demokrishterë. Do të jetë shtim i durueshëm në qoftë se i shtuari nuk do të jetë akademiku i çakërdisur Mark Krasniqi.

Mehmet Hajrizi tha:

- E paskan filluar fushatën zgjedhore.

Hydajet Hyseni e shpjegoi mospajtimin e tij me këtë shtim: është e padrejtë që krahu i LDK-së të shtohet me një anëtar më shumë se dy krahët e tjerë për shkak se LDK-ja ishte kundër luftës çlirimtare, prandaj kundër të gjitha këtyre që janë arritur sot në Kosovë.

Hydajeti flet edhe për zgjerimin e rusëve në Kamenicë dhe tërheqjen e amerikanëve.

Hydajeti flet edhe për Mitrovicën.

- Këto, - thotë, - janë tendenca për ndarje të Kosovës.

Kovin e thërret një nëpunës. Del për pak. Kur kthehet na tregon se rreth 2000 shqiptarë janë nisur përmbi Urën e Ibrit - për të kaluar në anën që e kanë pushtuar serbët!

- I ka ndalur KFOR-i. Francezët. Situata është shumë e tendosur, thotë.

I pakësojmë fjalët sepse na pakësohet edhe disponimi.

E kuptueshme, jo, e pakuptueshme: na u mbyll goja kur duhej të bërtisnim!

Mendimet e Xhon Kovit më duken shumë të pacaktuara: as ujë, as bozë!

Mund të jetë se gaboj, po do të shohim.

Në mbrëmje merret vesh se jo dymijë po mbi tri mijë shqiptarë kanë provuar të kalojnë përtej Ibrit, në pjesën e Mitrovicës, të pushtuar nga serbët, dhe të hyjnë në shtëpitë e veta, por nuk i kanë lënë ushtarët francezë në kuadrin e NATO-s.

Ushtarët francezë kanë përdorur dhunën ndaj shqiptarëve. Ka edhe të lënduar.

### 8.8.1999

E diel.

Mbrëmë, diku rreth mesnatës, është shkaktuar shpërthim i fuqishëm para ndërtesës së OSBE-së. Kanë filluar serbët prapë të na dhurojnë dhunë e terror!

Dita që sjell mërzi.

Nuk kemi ujë dhe nuk kemi rrymë elektrike.

Jetojmë jo gjithnjë e më lehtë, por gjithnjë e më rëndë.

Kushtet e mia jetësore janë aq të çrregulluara saqë nuk mund të punoj fare në bibliotekë. Po shterem shpirtërisht.

Vapë e madhe sa mezi merret frymë, kurse unë, o çfarë naiviteti, dua të jetoj si të isha tridhjetë vjeç e jam gjashtëdhjetë e tre vjeç. Kush e kalon masën e vet natyrore mund të përfundojë si tigri i Hemingueit në tregimin *Borërat e Kilimanxharos*, i cili mërdhin kur hyn në zonën natyrore që nuk është zonë e jetës së tij, në të cilën është i lindur dhe i mësuar.

Në asgjë s' duhet të kalohet masa që të është caktuar prej natyrës.

Ne, as në Shqipërinë shtetërore e lëre më këtu, në Kosovën aq gjatë të pushtuar prej Serbisë, ende s' e kemi dëgjuar fjalën gjeofilozofi, prandaj as të mendojmë me kuptime të saj.

Mora thirrje për pjesëmarrje në një seminar që e organizon Instituti Amerikan për Paqe. Seminari do t' i kushtohet temës *Ndërtimi i koalicionit demokratik*. Sa mirë: amerikanët duan të na mësojnë si të bëjmë koalicione demokratike e ne ende s' jemi

liruar shpirtërisht prej rrathëve despotikë orientalë! As prej rrathëve komunistë!

**10.8.1999**

Vapë tropikale.

Mosdurimin ndaj vapës e shton lagështia e madhe që e rëndon tepër frymëmarrjen.

Por, mosdurimin ndaj vapës e shton edhe mungesa e ujit.

Shkencëtarët nuk po flasin kot për ndryshimet klimatike në planetin e Tokës.

Nuk dola në punë edhe pse fëmijët e Viollës, Vesa dhe Leka, në regji të Valjetit, e kanë kthyer shtëpinë në sallë teatrore, ku po luajnë rolet e tyre artistike e po më tërheqin vëmendjen më shumë sesa librat.

Pas dite, në shtëpi, erdh shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Dan Everts, dhe erdhi me ish-oficerin britanik Dejvidin dhe me Artanin si përkthyes.

Duan të bisedojmë për situatën në Kosovë.

- Si të ndalet kjo rrjedhë anarkike? - pyet Dan Evertsi? - Si të disiplinohen shqiptarët? - pyet. - Si të disiplinohet UÇK-ja? - pyet.

I përgjigjem:

- Shqiptarët janë të dëshpëruar në administratën ndërkombëtare këtu.

- Pse? Pse? - pyet Dan Evertsi, sigurisht i befasuar.

- E para, nuk po ndiqen kriminelët serbë që kanë bërë krime ndaj shqiptarëve dhe që kanë marrë pjesë në pastrimin etnik të Kosovës. Ende nuk u tha se është kapur ndonjëri prej tyre dhe ende nuk u dëgjua se është dënuar ndonjëri prej tyre! Ç'do të thotë kjo? Do të thotë se ndërkombëtarët s'duan të dënojnë bërësit e krimeve ndaj shqiptarëve.

E dyta, në Mitrovicë po durohet pa reagime ndarja e qytetit nën mbikëqyrjen proserbe të francezëve! Pse? Ndoshta sepse

francezët dhe të tjerët kanë qëllimin e tyre: ndarjen përfundimtare të qytetit!

E treta, në Kamenicë ushtarët rusë luajnë rol të hapët proserb! Pse lejohet kjo në Kamenicë dhe në Fushë Kosovë? Pse lejohet ky patronazh proserb i rusëve? Ndoshta me qëllim, që kështu të vihen gurëthemet e para të ndarjes së ardhshme të Kosovës!

Dan Evertsi dhe Dejvidi qeshin.

- A doni të dhëna të tjera pse shqiptarët janë të dëshpëruar me administratën ndërkombëtare? - i pyes.

Ndoshta po, doni! Ndarja e Mitrovicës është e qëllimshme, ashtu siç janë të qëllimshme sjelljet proserbe të rusëve!

Dhe të francezëve!

Vërej se edhe Dan Evertsi, edhe Dejvidi, i dëgjuan me mirëkuptim fjalët e mia për francezët dhe për rusët.

- E për marrëdhëniet e liderëve shqiptarë, ç' mund të thuash për to? - më pyet Dan Evertsi.

I përgjigjem:

- Edhe në Kosovën e pasluftës po vazhdon avazi i vjetër i punës së shqiptarëve kundër vetvetes! Po të mos harrojmë: ndasitë tona janë zgjatim i ndasive evropiane prej Kongresit të Berlinit e këndeje. Disa vende evropiane duan njerëzit e tyre këtu, prandaj përkrahin Iksin a Ipsilonin pa shikuar kush është kush dhe kush çka ka bërë dje e çka po bën sot! Italia, Franca, Rusia, Greqia, si shtete, cila më pak, e cila më shumë, e cila plotësisht proserbe, duan të kenë kandidatin e tyre këtu, që do të zbatojë kërkesat e tyre. Për këtë arsye e përkrahin kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe pse ishte kundër UÇK-së, edhe pse ishte kundër bombardimeve të NATO-s, edhe pse kishte lidhur marrëveshje me kryetarin e Serbisë, Millan Millutinoviçin, për krijimin e qeverisë kuislinge në Kosovë, në prill të vitit 1999! Edhe pse të gjithë ndërkombëtarët e dinë mirë, shohin dhe dëgjojnë qartë, se ai, Rugova, është moralisht i rrënuar, disa prej tyre e shtynjë përpara, e favorizojnë, e shtojnë krahun e tij me më shumë anëtarë se dy krahët e tjerë në Këshillin Kalimtar të Kosovës! Do të shohin se



po gabojnë siç gabuan edhe në verë të vitit 1998, kur e lejuan Serbinë që të zhvillojë ofensivë të tmerrshme kundër shqiptarëve, me shpresë se shumë prej tyre do t'i detyrojnë të zhvendosen dhe me shpresë se do të zhdukin UÇK-në. Por, UÇK-ja nuk u zhduk, ndërsa shqiptarët e zhvendosur me dhunë, më në fund, u kthyen në shtëpitë e tyre.

E vazhduam bisedën për zgjedhjet e ardhshme.

Biseda për zgjedhjet, për mua, është si bisedë për borën e parvjetme! E të tjerëve, që janë në politikë, të cilëve kur përmenden zgjedhjet u del tym për gojë!

### **11.8.1999**

E mërkurë.

Vapa është bërë dërrmuese

38 gradë Celsius!

Një vapë e tillë është shumë, shumë e rrallë në Kosovë.

Nuk dola prej shtëpisë.

Asnjë pikë ujë!

Shërbimet komunale po terrorizojnë qytetarët!

A mendojnë ato se ashtu nuk bëhet dhe nuk mbahet shteti.

Paradite erdhi këshilltari i kryeministrit të Shqipërisë Pandeli Majkos, Eduardi. Me të janë Ibrahim Kelmendi dhe Ramiz Lladrovci. Më njoftuan se Pandeli Majkodo të vijë të premtën në Kosovë dhe dëshiron të takohet edhe me mua.

- Më gëzon takimi me të, - u përgjigjem.

- Por ende nuk është caktuar as vendi e as koha e takimit, - më thonë.

U përgjigjem:

- Dëshira ime është të takohemi në shtëpinë time, por mund të takohemi edhe në Institutin Albanologjik.

- Do të vij edhe njëherë te ju, - thotë këshilltari i kryeministrit Pandeli Majko.

Në mbrëmje Eduardi dhe Ramizi vijnë rishtazi.

- Takimi do të mbahet diku rreth orës 19:00, - thotë Eduardi.

Por, nuk mund të thonë nëse takimi do të jetë në shtëpinë time a në ndonjë zyrë. Do të shihemi, prandaj, prapë.

## 12.8.1999

Edhe më tej vapë - e madhe.

As sot s'kemi ujë. Po thonë: ka prishje të madhe në pjesën e ujësjellësit në Kodër të Diellit.

As sot nuk punon lidhja telefonike e shtëpisë! Nuk punon as në Radiostacionin *Kosova e lirë*, që është shumë afër shtëpisë sime.

Erdhën dy telefonistë që ta ndreqin, por as për pesë orë punë nuk arritën ta ndreqin!

Me teknikën s'i kemi punët kurrqysh! Unë, vetë, nuk di as poçin elektrik ta ndërroj: tutem prej tij si prej rrufesë! E, megjithëkëtë dikush më quan shkrimtar modern e dikush postmodern! Shkrimtar postmodern me kulturë teknike parahistorike!

Isha te Ramë Buja, tani ministër për të ashtuqjiturin pushtetin vendor (lokal). Kërkova prej tij që ta kthejnë në banesën e tij, të cilën ia ka uzurpuar një shqiptar, kirurgun e njohur, mysliman, Ismet Kandiçin.

- Ky, Kandiçi, është një mjek prej Plavës, qytet në Luginën e Plavës e Gucisë. Playjanët i kanë strehuar të zhvendosurit tanë në vitin 1998 e 1999 më kujdesshëm e më mirë se askund tjetër. Kështu tregojnë ata që ishin atje të zhvendosur. Është e palejueshme që tani t'i shpërblejmë me përndjekje dhe uzurpime të banesave. Duhet të mendojmë në mos ashtu, duke përndjekur myslimanët nga Plava, Gucia dhe Sanxhaku, po përndjekim një pjesë të popullit tonë. Siç e thonë historianët tanë dhe të tyre, ata janë etnikisht shqiptarë, që pas luftërave ballkanike, pas pushtimit nga Mali i Zi, kanë filluar ta flasin serbokroatishten. Por, pjesa më e madhe e tyre nuk e kanë harruar shqipen.

Ramë Buja më premtan se do ta zgjidhë këtë problem. Do ta zgjidhë, natyrisht, në qoftë se pas uzurpuesit nuk qëndron ndonjë uzurpues më i madh se uzurpuesi i banesës! E, mund të jetë. Kur ishte tek unë, për të më njoftuar se e kanë qitur prej banesës me kërcënime se do ta vrasin, Kandiçi më tha se këtë katrahurë ia kanë përgatitur disa nga kolegët mjekë, sigurisht me pajtimin e ndonjë zyrtari tonë gjithnjë e më të fuqishëm. E mund të jetë kështu si më tha Kandiçi. Ai konsiderohet kirurgu më i mirë i abdomenit në Kosovë, prandaj ata që e xhelozojnë mendojnë se duke e nxjerrë prej banesës e dëbojnë edhe prej Kosovës!

- Në qoftë se mbetem pa banesë, - tha Kandiçi, - do të jem i detyruar të shpërngulem prej Kosovës. Do të shkoja në vendlindje, por atje nuk ka punë për mua, prandaj do të shpërngulem diku në Bosnjë.

### **13.8.1999**

Kryeministri i Shqipërisë, Pandeli Majko, ka mbërritur në Prishtinë.

Së pari ka vizituar Universitetin e Prishtinës dhe është takuar me rektorin dhe me një numër të studentëve.

Në orën 16:00 Pandeli Majko, me delegacionin e tij, erdhi në takim me mua, në shtëpinë time. Me të ishin edhe Ilir Meta, Gramoz Pashko dhe disa këshilltarë. Përcjellja e tij ishte pak a shumë e madhe. Dhe dukshëm e dinjitetshme. Delegacionin e Pandeliut edhe më të madh e më të dinjitetshëm politikisht e bëjnë dy shumë të merituarit: Iliri e Gramozi.

Me ta ishin edhe shumë gazetarë.

Udhëheqësit politikë e shtetërorë të Shqipërisë shtetërore janë me të vërtetë doktorë të propagandës. Është shkollë e kryer në kohën e lidhjeve të Tiranës zyrtare me Moskën komuniste.

U përpoqëm t'i presim sa më mirë. U thashë:

- Kam kënaqësi të veçantë t'ju dëshiroj mirëseardhje në Kosovë dhe kam kënaqësi të veçantë t'ju dëshiroj mirëseardhje në shtëpinë time. Nuk e di a keni qenë ndonjëherë më parë në Kosovë, por pavarësisht prej kësaj, ardhja juaj në Kosovë në një kohë menjëherë pas luftës është ardhje shumë domethënëse. Them kështu sepse ju po vini në Kosovë në një kohë historike për Kosovën, sepse ju po vini në një Kosovë të ndryshuar, në një Kosovë të re, në të gjitha pikëpamjet të re. Këtë ndryshim historik ia kanë sjellë Kosovës djemtë e Kosovës, dhe një varg djemsh nga Shqipëria shtetërore; këtë ndryshim ia kanë sjellë Kosovës populli shqiptar në përgjithësi dhe forcat e NATO-s në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ju po vini në Kosovën prej së cilës është dëbuar regjimi pushtues serb, prej së cilës janë dëbuar forcat ushtarake, paraushtarake e policore serbe, në të cilën kanë ardhur forcat ndërkombëtare në krye me NATO-n, në të cilën ka ardhur Misioni i OKB-së në krye me mjekun e njohur francez, Bernard Kushner. Dhe, me pjesëtarët e këtij Misioni ne po ndërtojmë pushtetin e protektoratit. Në këtë Kosovë ju priteni lirisht e me gëzim të madh prej shqiptarëve. Në këtë Kosovë sot ju mund të shkoni lirisht ku të doni. E kjo vetëm para sa muajsh as nuk mund të merrej me mend.

Ardhja juaj në Kosovë sot ka edhe një domethënie të veçantë, një domethënie simbolike.

Ju, sot, i drejtohem duke e shikuar kryeministrin Pandeli Majko, keni fejuar vëllanë me një kosovare. Uroj që të jenë të lumtur e të trashëgohen. Fejesa të tilla, fejesa e martesë të tilla, mes djemve e vajzave të Kosovës e të Shqipërisë shtetërore, ka pasur, ç'është e vërteta më pak dikur, ka sot e do të ketë gjithnjë e më shumë në të ardhmen, por kjo fejesë e sotme është e veçantë. Kjo fejesë është fryt i jashtëzakonshëm i mikpritjes, i bujarisë, i pritjes së jashtëzakonshme që Shqipëria shtetërore u bëri sivjet bashkëkombësve të vet, të zhvendosur me dhunë nga Kosova. Ju me atë kujdes, me atë pritje të jashtëzakonshme e mrekulluat edhe

botën dhe u dhatë kontribut historik lidhjeve shpirtërore, morale, të përgjithshme pjesëtarëve të Kombit shqiptar. Në ato kushte të kujdesit të jashtëzakonshëm u krijua lidhja që sot u kurorëzua me fejesë. Të gjitha këto janë arsyeja pse vizitën tuaj sot shqiptarët e Kosovës e pranojnë me shumë ndjenja. Dhe, me shumë shpresa.

Mbasi më falënderoi për fjalët që thashë, kryeministri Pandeli Majko më pyeti:

- E si më tutje? Çka të bëjmë më tutje?

Dolën kameramanët. Ne e filluam bisedën, më çlirshëm, për problemet e tanishme të Kosovës. Thashë vetëm kaq:

- E para, ende nuk kemi strategji të menduar mirë, të përgatitur kujdesshëm, të veprimit politik dhe të veprimtarisë së përgjithshme: ato që duhet të bëhen kujdesshëm, studiueshëm, për tri vjet ne jemi turrur t'i bëjmë për tri javë a tre muaj dhe po i bëjmë pa i menduar pasojat e tyre.

E dyta, jeta jonë po anarkizohet dhe kjo bëhet e rrezikshme për ne sepse bëhet komprometuese në sytë e ndërkombëtarëve.

E treta, jemi duke e humbur mirëkuptimin e faktorëve ndërkombëtarë për ç'shkak gjenerali britanik, Majk Xhekson, deklaroi këto ditë se muaji i mjaltit me shqiptarët po merr fund më shpejt se ç'është menduar!

Ka edhe të këqija të tjera, me të cilat nuk po ju rëndoj tani. Gjatë vizitës ju do të keni rastin të dëgjoni për të këqijat e të mirat në jetën tonë të sotme.

Pyetët çka të bëjmë? Të bëjmë politikë që mënjanon këto të këqija dhe parandalohen të tjera si këto. Dhe, të ndërtojmë strategjinë politike, qëllimi i së cilës do të jetë pavarësia e Kosovës. Dhe, kjo do të jetë strategji e përbashkët Shqipëri-Kosovë. Jemi vëllezër e vëllezërit duhet të punojnë sa më mirë e sa më shumë që të dinë e mundën për shtëpinë e përbashkët. E Shqipëria dhe Kosova janë kjo shtëpia jonë e përbashkët.

Kryeministri Pandeli Mako më falënderoi për këto shpjegime. Lamtumiremi me shumë përzemërsi.

**14.8.1999**

E shtunë.

Vapë pak a shumë e mëshiruar ndaj atyre që kanë arsye shëndetësore të mos e durojnë.

Paradite u takova, në shtëpi, me një grup veprimtarësh ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut: dy holandezë, një angleze dhe dy francezë, që i takojnë Shoqatës Civile të Helsinkit. Grupin e udhëheq drejtori i Shoqatës, dr. Mient Jan Faber - holandez.

Tek unë i kishte çuar shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Dan Everts.

U bë një bisedë interesante, më shumë me meritën e tyre, që zgjati pak më tepër se një orë.

U bisedua: për numrin e partive tona politike, që sot për sot ata e çmonin të tepërt; për LBD-në dhe për programin e saj; për të përbashkëtat dhe dallimet mes partive shqiptare; për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës; për mospajtimin e fqinjëve ballkanikë, natyrisht jo të gjithëve, me pavarësinë e Kosovës; për mundësinë e organizimit të referendumit për ardhmërinë e Kosovës. E për çështje të tjera më pak të rëndësishme.

Njëri nga francezët më pyeti:

- Çka do të bëhej me Kosovën po të pavarësohej?

- E di se çfarë përgjigje prisni që t'ju jap.

Qeshen të gjithë.

- A mund të na e thoni?

- Po si jo. Kosova e pavarur do të jetë shtet demokratik në të gjitha pikëpamjet demokratik, me të drejta të barabarta të të gjithëve që kanë jetuar dhe jetojnë në Kosovë, duke përfshirë, këtu, natyrisht, edhe serbët.

Dhe, e ndala fjalën.

Më shikuan të befasuar të gjithë, sidomos, francezi që më bëri pyetjen.

- Aq? - pyeti francezi.

- Po ua them edhe atë që ju e prisni: Kosova e pavarur, demokratike në të gjitha pikëpamjet, pas një kohe do të bashkohet me Shqipërinë.

Qeshën më zëshëm se herën e kaluar.

- Ju faleminderit për përgjigjen e sinqertë, - tha ai, francezi.

Prijësi i grupit, holandezi, ishte fort korrekt, i kujdesshëm me pyetjet dhe me konstatimet e tij.

- Unë, - tha, - e përkrah idenë për referendumin me të cilin do të vendosej për pavarësinë e Kosovës.

- Për pavarësinë e, më vonë, për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, - ia ktheva unë.

Qeshën, prapë, të gjithë njëzëshëm.

Pasdite, në orën 16:00, u mbajt mbledhja e Kryesisë së zgjeruar të LBD-së. Kishin ardhur gjithsej 12 veta.

I kemi siguruar zyrat në ndërtesën e gjahtarëve - derisa të mos na e marrin. E ka filluar punën njëfarë administrate: sekretari administrativ - Zenun Pajaziti, telefonistja, pa telefon, një nëpunës tjetër, pa kompjuter dhe një gazetar.

U morëm vesh për mbledhjet e degëve dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të Kryesisë në to. Herën tjetër, u pajtuam, do të bisedojmë për rolin e anëtarëve të LBD-së në Qeverinë e Përkohshme, e cila me sjelljet e saj po e zhvlerëson politikën tonë dhe ashtu po zhvlerësohemi të gjithë para ndërkombëtarëve. Mehmeti, Hydajeti dhe Bajrami shprehin pakënaqësi me punën e kësaj Qeverie. Nuk u ka dalë siç kanë pritur.

- Hashimi po sillet si sulltan, - thanë. - As nuk pyet kë, as nuk e intereson kush, përpos atyre të rrethit të tij, të klanit të tij vendor, - thanë.

- Sëmundja jonë e vjetër, bajraktarizmi, - i ngushëlloj unë. - E bajraktarët s'janë njësoj dhe s'e zbatojnë të gjithë bajraktarizmin e tyre bash njësoj.

## **15.8.1999**

E diel.

Ditë pushimi.

Në Institut mora pjesë në përrurimin e ditarit të luftës të Nusret Pllanës.

Kanë ardhur shumë dëgjues, më shumë se kur përurohen libra të profesorëve të Universitetit apo të anëtarëve të Akademisë. Ditari ka rreth 140 faqe. Në të më shumë paraqiten mendime politike, që i dinë të gjithë se ç'paraqiten ngjarje, që do t'u interesonin të gjithëve. Prej fjalëve që thuhet për këtë Ditar të krijohet përshtypja se luftë në Kosovë kishte pak. Ç'është e vërteta, ky Ditar mbulon me fjalë verën e vitit 1998, domethënë kohën e ofensivave të forcave serbe!

Për Ditarin folën Jahir Ahmeri, Shefkije Islamaj, Emin Kabashi, R. Gashi dhe Behram Hoti, që ishin përgatitur me shkrim. I thashë edhe unë disa fjalë për këtë Ditar, si një dokument historik.

Më përshtypjebërëset ishin fjala e Shefkijes dhe fjala e Jahirit.

Në Krushë të Madhe sot janë varrosur babai dhe vëllai i Ukshin Hotit. Nuk arrita të shkoj për arsye se nipi i vogël dhe mbesa edhe më e vogël kishin të vjella dhe temperaturë të lartë dhe u desh t'i çojmë te mjeku, në Spitalin e Përgjithshëm.

## **16.8.1999**

Punova në projektprogramin e Lëvizjes së Bashkuar Demokratike. Në të vërtetë e ripunova programin që kisha bërë disa vjet më parë për nevojat e disa miqve që donin të bënin parti. Bëra disa plotësime. Nuk hoqa tjetër përpos faqes së parë: hoqa atë që doja më së shumti - idenë e bashkimit kombëtar politik e territorial dhe shtova idenë e integriteteve evropiane, që kurrë nuk



do të mund të bëhet zëvendësim për bashkimin tonë kombëtar, që përfaqëson zgjidhjen përfundimtare, historike të çështjes shqiptare, prandaj edhe të çështjes së Kosovës.

Udhëheqja e protektoratit s'pranon program partiak në të cilin parashihet bashkimi i Kosovës me Shqipërinë!

Makina e shkrimit nuk punon: është tharë shiriti e shiritit tjetër tani për tani nuk kam.

### **17.8.1999**

Violla dhe Visari me fëmijët, Vesën dhe Lekën, janë shpërngulur përkohësisht në Shkup.

Më mungojnë shumë sherret e Vesës e të Lekës.

Shpresa u mërzit për ta edhe më shumë se unë.

### **18.8.1999**

U mbajt mbledhja e Këshillit organizues të Simpoziumit *Lufta çlirimtare e popullit shqiptar të Kosovës dhe roli i UÇK-së në të*. U shqyrtuan temat e paraqitura për trajtim. U morëm vesh që simpoziumi të mbahet në gjysmën e dytë të shtatorit sepse disa prej pjesëmarrësve më 10-13 shtator do të jenë në Uashington në një konferencë për koalicionet demokratike.

Agim Çeku kërkoi ta ndihmoj në përgatitjen e referatit, që do të paraqesë në atë konferencë.

Nesër në mbrëmje unë e ai do të takohemi në Shtabin e Përgjithshëm për të biseduar në lidhje me përgatitjen e atij referati.

### **19.8.1999**

Në orën 18:00 erdhën e më morën me xhip tre djem nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së për të më çuar në takim me Agim Çekun.

Me ne në bisedë ishte edhe Muharremi.

Agimi më tregoi se me Uesli Klarkun është arritur një pajtim që Kosova të ketë forcë mbrojtëse deri në katër mijë veta, së cilës do t'i caktohet emër i ri.

- Me Uesli Klarkun, - tha Agimi, njeriu merret vesh shumë më lehtë se me disa të tjerë. Besoj se mendoj: më lehtë se me disa të tjerë të këtushëm.

Sa më e cekët mendja aq më e vështirë marrëveshja me pronarin e saj! Kështu mendonte Gëtja i madh.

Pastaj biseduam, gjerë e gjatë, rreth çështjeve që duhet të paraqesë Agimi në referatin në konferencën për koalicionet, që do të mbahet në Uashington, ku është ftuar. U pajtua me çështjet - temat që ia propozova.

Djemtë në uniforma, që punojnë në Shtabin e Përgjithshëm, më lanë përshtypje jashtëzakonisht të mirë: janë të shëndoshë, të pashëm, të sjellshëm, të disiplinuar. Më bëhet zemra mal kur i shikoj.

## **20.8.1999**

U takova me sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së, sllovakun Jan Kubas.

Takimi u bë në Bankën sllovene. Me të ishte edhe shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Dan Everts.

Përkthyes ishte Artani, nipi im.

Jam me Mehmetin, Hydajetin dhe Bajramin.

Jan Kubas e hap bisedën me dy fjali, të shkurtra.

Shihet se nuk është shumë i interesuar për situatën aktuale në Kosovë: sigurisht do ta ketë informuar Dan Evertsi, prandaj pyeti se kur është mirë të mbahen zgjedhjet. Unë, megjithatë, i përsërita si papagall ato që po ua them të gjithë të huajve si përgjigje për të njëjtën pyetje që bëjnë për zgjedhjet në Kosovë.

- Zgjedhjet, - thashë, - nuk do të duhej të mbahen para një viti; më mirë do të ishte të mbahen mbas një viti e gjysmë. Arsyet pse

mendoj kështu janë: strehimi i atyre që s'kanë kulm mbi krye, regjistrimi i popullsisë së Kosovës, regjistrimi edhe i atyre që janë përjashta, marrëveshja për sistemin zgjedhor, miratimi i ligjit zgjedhor, përgatitjet e partive dhe regjistrimi i tyre, përgatitja materiale e teknike e Kosovës për zgjedhjet, ngritja e nivelit të sigurisë. E të tjera.

Nuk kuptova mbet i kënaqur a i dëshpëruar Jan Kubasi me shpjegimet e shkurtra që ia thashë për zgjedhjet.

Ishte njeri shumë i kursyer në fjalë dhe në buzëqeshje, së paku, këtu, me ne.

U kujdesa që të lamtumiremi zyrtarisht me të.

## **21.8.1999**

Isha në mbledhjen e Këshillit Kalimtar të Kosovës, që u mbajt në ndërtesën dikur e quajtur Shtëpia e Armatës, kurse tani Shtëpia e UNMIK-ut.

Ora 15:00.

E shtunë. Ndërkombëtarët në Kosovë nuk ngurrojnë të punojnë edhe të shtunën, edhe të dielën, kur ne jemi mësuar doemos të pushojmë.

Të pranishëm: Bernard Kushneri, Majkëll Xheksoni, Dan Evertsi, dhe përgjegjësi për policinë, Frederikson.

Mungojnë Hashim Thaçi dhe përfaqësuesi i dytë i LDK-së, kurse përfaqësuesi i parë i LDK-së, Ibrahim Rugova, është i pranishëm.

I ka ngjyrosur flokët si kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Sali Berisha.

E ka hequr shallin, ndoshta pse është vapë e ndoshta pse në mbledhje me ndërkombëtarët mendon se nuk duhet të mbahet shall.

Mbledhjen e udhëheq Bernard Kushneri. Flet mjaft të madhe. E zgjati shumë fjalën. Është i logjikshëm. Është gojëtar i mirë.

Energjik dhe gojëtar - korsikas i vërtetë. E përshkruan gati në hollësi gjendjen e Kosovës. Ia vë theksin sidomos sigurisë. E ankton, por butë-butë, fatin e serbëve.

Mbas Kushnerit e merr fjalën gjenerali Majkëll Xhekson. Flet për sigurinë. Flet me shifra, me një tabelë në të cilën paraqet shpeshhtësinë e krimeve në disa qytete e vende në botë dhe në Kosovë. Numri i krimeve në Kosovë, thotë, tregon prirjen e rënies. Jam optimist, shton.

Mbas tij e merr fjalën peshkopi Artemije.

E dramatizon shumë gjendjen e serbëve.

E kritikon Majkëll Xheksonin.

Dhe e kritikon për ato që tha duke zbritur numrin e krimeve në Kosovë.

Nuk e kurseu as Kushnerin.

Mbas peshkopit Artemije foli Mehmet Hajrizi.

Iu kundërvu shumë bindshëm, me të dhëna, Artemijes.

Mbas Mehmetit flet Bilalli, Bilall Sherifi: arsyeshëm, shumë arsyeshëm.

Mbas Bilallit e merr fjalën Numan Baliqi: kur mirë e kur keq.

Mbas tij flet përfaqësuesi i turqve, Sezai Shaipi: kësaj radhe kujdesshëm.

Mbas Sezai Shaipit fjalën e merr Ibrahim Rugova: e falënderon dhe e lavdëron Bernard Kushnerin, e paraqet shumë të përparuar situatën e përgjithshme dhe, prapë, e falënderon dhe e lavdëron Bernard Kushnerin, tani për këtë përparim të situatës!

Mandej e merr fjalën Trajkoviqi: i përsëriti me gjuhë më pak a më shumë komuniste, në të vërtetë neostaliniste, fjalët e peshkopit Artemije.

Mbas tij e marr fjalën unë.

- Ju, - iu drejtova peshkopit Artemije dhe Trajkoviqit, - po barazoni fatin e shqiptarëve dhe serbëve dje e sot, në të kaluarën dhe në të tanishmen! Ju po harroni se prej vitit 1912 Serbia e mandej Jugosllavia ishin pushtuese në Kosovë! Ju po i harroni gjithë projektet e ideologëve intelektualë dhe politikanë serbë për

zhvendosjen e shqiptarëve nga Kosova! Ju po harroni kolonizimin e Kosovës me serbë ndërmjet dy luftërave botërore! Ju po harroni gjithë dhunën dhe terrorin e shtetit serb ndaj shqiptarëve gjatë shekullit njëzet dhe tani njëzet e një! Ju po e harroni dhunën dhe terrorin e regjimit të Millosheviqit që i ka shkaktuar aq shumë gjakderdhje e aq shumë vuajtje popullit shqiptar të Kosovës! Unë nuk doja të flisja për këto çështje tani, por ju e fjalët tuaja tepër provokuese më nxitën. Unë do të doja të bisedonim tani, këtu, për mundësitë me të cilat do t'ua bënim jetën sadopak më të kuptueshme e më të dinjitetshme e më të lehtë të gjithë qytetarëve të sotëm të Kosovës.

Mbas meje menjëherë e mori fjalën Bernard Kushneri. U përgjigjet të gjithëve duke ua përmendur emrat e më përgjigjet edhe mua dhe na përgjigjet të gjithëve duke thënë për secilin nga një fjalë të mirë dhe nga një fjalë të vështirë.

Mjeshtëri politike, por edhe etike.

Në fund të fjalës së tij, Bernard Kushneri na njoftoi se e mërkura do të jetë ditë e takimeve tona të rregullta.

## **22.8.1999**

E kalova një pjesë të madhe të ditës duke e kërkuar një fletore të shënimeve, në të cilën janë edhe një varg numrash telefonikë të atyre miqve, kolegëve e të njohurve të ndryshëm, me të cilët jam takuar e kam biseduar në kohë të ndryshme. E rrotullova bibliotekën, po nuk e gjeta.

Dikur erdhi Valjeti dhe iu kushtua kërkimit të kësaj fletoreje më shumë se një orë. Kot. As duart e tij të shkathëta e as sytë e tij, që shohin aq qartë, nuk e gjetën!

Kush e di se ç'ka ndodhur me të. E kanë marrë ata që kanë hyrë në shtëpi kur nuk ishim ne në të: policët e paramilitarët serbë. Apo e kam humbur unë kur dhe ku nuk më kujtohet.

Valjeti më është bërë dora e djathtë dhe mendja përkujtuese, ndonëse me moshë të vogël - 12 vjeç. Është i mençur, është i mirësjellshëm, është spirituoz, që nuk të lë kurrë të mërzhitesh. Është i shëndoshë dhe është i pashëm, në të vërtetë i bukur. Në të gjitha pikëpamjet është i mrekullueshëm - dhuratë e jashtëzakonshme e nënës Natyrë. Ruaje, Zot.

Doniku i vogël edhe më tej i përkushtohet lojës. Nuk vjen në shtëpi pa e thirrur. E do shumë natyrën. Kur vjen e zbukuron shtëpinë me të gjitha: me pamjen e tij dhe me fjalët e papritura, që mund t'i shqiptojnë vetëm fëmijët në moshë më të madhe se ç'është e tij. Është i bukur, është i shëndoshë, është i dëgjueshëm dhe është më i ndjeshëm se i vëllai Valjeti. Mirësjellja e tij përmban një kuptim të veçantë. Ruaje, Zot!

Çka të them për motrën e tyre të vetme, Lironën, që është më e vogël se Doniku, që e quaj engjëlli i shtëpisë. Ende nuk është shkoqur prej prehrit të nënës.

### **23.8.1999**

U takova me tre përfaqësues të Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë: me zëvendësin e ministrit të Jashtëm, Paskal Milos, me diplomatin tashmë të caktuar në përfaqësinë e Shqipërisë në Beograd dhe me drejtorin e Institutit të Diasporës pranë Ministrisë së Jashtme. Jam parë me dy të parët më shumë herë në Tiranë derisa isha refugjat, kurse me të tretin po shihem tani për herë të parë.

Biseduam gjatë, gjatë, për Kosovën sot dhe nesër.

U takova sot edhe me deputetin e Parlamentit Evropian, me belgun Bart Staes dhe me një bashkëpunëtor të tij. Ky deputet belg ishte flaman; dhe mik i shqiptarëve. Tha se në Parlamentin belg do të flasë për propagandën e sotme serbe me të cilën zëdhënësit e regjimit të Millosheviqit po bëjnë çmos për t'i paraqitur shqiptarët si shfarosës të serbëve. Kur u lamtumirëm më tha:

- Mirupafshim në Kosovën e lirë (të pavarur)!

**24.8.1999**

U takova me sekretarin e Ambasadës suedeze në Beograd, Julius, me të cilin jam takuar edhe shumë herë të tjera. Shihet se e ka shtuar dukshëm peshën. Biseduam për situatën politike në Kosovë, për partitë politike, për marrëdhëniet e tyre, për serbët, për Mitrovicën, për të ardhmen e Kosovës.

- Gjatë bombardimeve, - më tha në fund, - isha në Beograd.

Më vonë, në orën 12:00, u takova me britanikun Bryan Hopkinson, drejtor i Projektit Kosova.

Do të dijë kush është kush në politikën e sotme kosovare.

Ka të dhëna jetëshkrimore për shumicën prej tyre. Dëshiron t'i plotësojë dhe t'i saktësojë ato të dhëna. Nuk ia plotësoj këtë dëshirë. Jetëshkrimet e njerëzve shtohen për ditë, duke u përmirësuar e duke u keqësuar, them.

Qeshën zëshëm.

Thotë se ishte ambasador britanik në Bosnjë.

Fjala që thotë është e shpejtë, lehtë e shqiptuar, si e nxjerrë prej xhepit!

Merr shënime shkurt.

Është tip atraktiv.

Dhe, tip fragmentar.

- E kam të paqartë, - thotë, - të ardhmen e Hashim Thaçit. - Do të bëjë parti politike, - thotë, - por ajo s'mund të bëhet parti e rëndësishme.

Pse mendoni ashtu? e pyes.

- Sepse Thaçi shquhet me dinakëri e jo me mençuri. Ai nuk e di se dinakëria nuk është mençuri njerëzore, por shkathtësi e disa shtazëve të egra më tepër se të buta.

- Dinakëria, - i përgjigjem duke qeshur, - është ligësi politike edhe e evropianëve, e trajtuar seriozisht prej Makiavelit.

- Është e komprometuar plotësisht në shkrimet e filozofëve të Iluminizmit e të Demokracisë mbas Makiavelit.

- Mendimet e këtyre filozofëve ende nuk kanë mbërritur dhe nuk do të mbërrijnë edhe shumë kohë në Ballkan.

- Si po shihet keni të drejtë, - përgjigjet.
- Ballkani, ka thënë një evropian, nuk është nocion vetëm gjeografik, është edhe mentalitet.
- Partia juaj, - thotë, - LBD-ja, është parti e djathtë.
- Edhe në të, si në të gjitha partitë tona, ka edhe shumë majtakë,
- i them duke qeshur.
- S'e kupton domethënien e fjalës majtak.
- S'arrita t'ia shpjegoj mirë. Fjala invalid nuk e shpreh përkatshëm.

U lamtumirëm me humor të mirë në sajë të shakave që bëmë me “virtytet” e njerëzve të politikës.

Erdhi Agim Çeku. Biseduam për manifestimin e nesërm në Kleçkë dhe për fjalimin që do ta mbajë ai aty, si dhe për të tjerët që do të marrin pjesë në atë manifestim në Kleçkë.

## 25.8.1999

U mbajt mbledhja e Këshillit Kalimtar të Kosovës.

Kanë ardhur të gjithë anëtarët, me përjashtim të Blerimit dhe të Sezai Shaipit, turkut.

Mbledhjen e hapi Bernard Kushneri.

Foli gjatë, gjatë, por kësaj radhe foli e ç'foli, kodër mbas bregut!

Turr pas tij e mori fjalën Hashim Thaçi. Tha:

- Në qoftë se flitet për kantonizimin e Kosovës, që e kanë kërkuar serbët, kurse Kushneri propozoi tridhjetë minuta për diskutim rreth tij, do ta lëshoj mbledhjen.

Dhe, propozoi dy pika të reja të rendit të ditës:

e para, çështja e sigurisë, që është diskutuar në mbledhjen e kaluar, dhe,

e dyta, Fondi i Bukoshit.

Mbas këtij propozimi iu përgjigj Veton Surroit dhe të tjerëve që po flasin për “fashizëm” dhe për “terrorizëm” në Kosovë. Dhe, vazhdoi të flasë kodër pas bregut!



Mbas tij e mori fjalën Veton Surroi dhe, duke bërë galimatiasë logjike dhe gjuhësore, propozoi të mos flitet për kantonizimin sado më parë vetë foli për të.

Mbas Vetonit foli Ibrahim Rugova. Tha, i mërrolur, se nuk pajtohet me Thaçin.

- Nuk mund të diskutohet për Fondin e Bukoshit. Ky është fond legal për nevojat e arsimit e të shëndetësisë. Në qoftë se diskutojmë për Fondin e Bukoshit duhet të diskutojmë edhe për fondin tjetër (për fondin Vendlindja thërret), - e përfundoi fjalën ai.

Pas fjalëve të Rugovës të pranishmit mbetën pa fjalë! Nuk ka dyshim se këto dy fonde, njëri i LDK-së e tjetri i UÇK-së, të krijuar prej xhepave të shqiptarëve në botë dhe në Kosovë, ishin një pyll i dendur në të cilin po humbte mendja dhe nderi i shumëkujt nga radhët e udhëheqësve të LDK-së dhe të UÇK-së e të kryesve të punëve të tyre të pista. S'mund të mos mendohej se për ato dy fonde sot, këtu, folën dy njerëz politikë të LDK-së dhe UÇK-së, ndoshta edhe vetë shpërdorues të atyre fondeve.

Anëtarët e Këshillit Kalimtar të Kosovës, shumica e tyre, mbetën duke shikuar njëri-tjetrin. Serbët, peshkopi Artemije dhe Trajkoviqi, po shkëlqenin prej gëzimit: shqiptarët do të fillojnë t'i tregojnë edhe punët e pista të njëri-tjetrit. Gjithnjë e më shpesh do të akuzojnë njëri-tjetrin për hajni, keqpërdorime, korrupsion, zhvatje, punë mafioze!

Në radhë, më tej, folën njëri pas tjetrit Numan Baliqi, Trajkoviqi, Kushneri, Mehmet Hajrizi, peshkopi Artemije.

Trajkoviqi u nis të dalë prej mbledhjes kur Mehmeti e kundërshtoi propozimin serb për kantonizimin e Kosovës.

E ndalën Bernard Kushneri dhe Veton Surroi.

Mandej e mori fjalën Rexhep Qosja.

- Në sallë, domethënë në mbledhje të këtij Këshilli, po shoh edhe njerëz që nuk janë anëtarë të Këshillit Kalimtar të Kosovës. Mund të jenë truproja, mund të jenë adjutantë, mund të jenë këshilltarë e ku ta di unë çka tjetër, por mendoj se nuk duhet të jenë këtu pa lejen e këtij Këshilli. Po u lejuan ata këtu, secili prej

nesh mund të sjellë këtu kë të dojë! Javën tjetër unë do të mund të sjell këtu tri veta. Nuk ju thashë se për shtruarjen e këtij problemi më nxiti prania këtu e historianit serb Batakoviç, i cili qëndron ulur pas peshkopit Artemije dhe Trajkoviçit. E ai, s' duhet të jetë këtu.

Çështja tjetër për të cilën dua të them dy-tri fjalë është çështja e rendit të ditës. Rendi i ditës, sipas mendimit tim, duhet të bëhet pas konsultimeve me përfaqësuesit e subjekteve politike të përfaqësuar në këtë Këshill. Dhe, rendet e ditës nuk do të duhej të jenë të mbingarkuara si deri sot, kurse mbledhjet nuk do të duhet të zgjasin më shumë se dy orë, siç po zgjasin.

Dua të them diçka edhe për kantonizimin. U befasova kur Zoti Kushner e quajti kantonizimin *vendosje e mbrojtur*. Prej kujt e mbrojtur? Përmbajtje e njëjtë, po emri tjetër: si kantonizim si vendosje e mbrojtur! Nuk mendoj kurrsesi, se këtë propozim duhet ta fusim nën tepih! Propozimi është bërë nga pala serbe dhe duhet ta diskutojmë me seriozitetin më të madh. Them kështu për shkak se kantonizimin e Kosovës, që po bëhet ngadalë-ngadalë dhe padukshëm, e konsideroj të rrezikshëm si për Kosovën ashtu edhe për rajonin. Meqenëse ju, Zoti Kushner, kërkuat që sot të mos flasim për kantonizimin, unë po ndalem këtu, kurse shpjegimet e mia më të hollësishme, për pasojat e atij farë kantonizimi a *vendosjeje të mbrojtur*, do t'i paraqes në mbledhjen e ardhshme. Ju faleminderit për vëmendjen!

I pari i Këshillit Kalimtar të Kosovës, Bernard Kushner, më dha të drejtë për çka fola dhe për propozimet që bëra.

- Këtu, në mbledhjet e këtij Këshilli, - tha, - mund të vijmë vetëm anëtarët e tij dhe specialistët që do të ftojme ne për tema të veçanta e në asnjë mënyrë kush tjetër.

Mbledhjet do të mund të zgjasin vetëm deri në dy orë.

Rendet e ditës do t'i përpilojmë në bazë të këshillimeve të përbashkëta.

Do të njoftohemi për mbledhjen e ardhshme në të cilën do të mund të diskutojmë edhe për kantonizimin, në të vërtetë për vendosjen e mbrojtur.

Ju faleminderit!

Në mbrëmje, në orën 20:00, erdhën, në shtëpi. Hashimi, Xhavit Haliti - Zeka, Bilall Sherifi dhe Agim Çeku. Erdhën me përcjellje: me disa vetura dhe me disa truproja. Veturave u janë vënë numrat, që fillojnë me zero, siç ua vinte edhe nomenklatura e “lashtë” komuniste.

Etja pushtetore e Hashimit është e paskajshme! Me të mund t’i silltë autokratizëm shumë i dëmshëm Kosovës, siç i është sjellë edhe Shqipërisë.

Biseduam gati dy orë.

Përgjigjet dhe, në përgjithësi, mendimet e Hashimit, i nyjetojnë (artikulojnë) ose Zeka, ose Bilalli, ose të dy, njëri pas tjetrit.

Më së gjati biseduam për çështjen e serbëve.

- Gatishmëria jonë, që të merremi në çdo mbledhje me ta, - thashë, - duke harruar një varg problemesh të tjera të njerëzve, sidomos të shqiptarëve, na ka sjellë ku u pa në mbledhjen e sotme: te kantonizimi. Kantonizimi i Kosovës, po u bë, përfaqëson rrezik të madh për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës. Kantonet serbe do të ishin Kalë Troje në Kosovë. Kantonet serbe, që Kushneri i quan *vendosje e mbrojtur*, do të bëheshin qendra për paqëndrueshmërinë (destabilizimin) e Kosovës e, dikur, edhe për ndarjen e saj të brendshme në, si të them, të fragmentarizuar.

Biseduam dhe për administratën e Kombeve të Bashkuara. Të gjithë i shohin drejt, si duhet, të mirat dhe të këqijat e kësaj administrate.

- Ne, - thashë, - duhet të bashkëpunojmë me pjesëtarët ndërkombëtarë të kësaj administrate, të jemi në strukturat e saj, por në anën tjetër duhet ta forcojmë pushtetin tonë vendor.

Biseduam për Shqipërinë. Të gjithë e theksuan rëndësinë e saj për luftën dhe për trajtimin e të zhvendosurve dhunshëm prej Kosovës gjatë bombardimeve. Unë e thashë vetëm fjalinë që po shkruaj këtu:

- Çdo gjë duhet ta bëjmë në marrëveshje me udhëheqjen e saj. Fati i shqiptarëve të Kosovës dhe i shqiptarëve kudo qoftë në Ballkan e në Evropë është i përbashkët me fatin e shqiptarëve të

Shqipërisë, i përbashkët, i pandarë. Kjo u pa sidomos gjatë luftës çlirimtare.

Biseduam edhe për zgjedhjet e ardhshme.

- Sipas bindjes sime, po u mbajtën shpejt këto zgjedhje, do të fitojë kush s'i takon të fitojë dhe kush s'duhet të fitojë -LDK-ja me partitë satelitore. T'i fitojnë zgjedhjet ata që ishin kundër luftës çlirimtare -ky do të ishte cinizëm i rëndë historik! Nuk e thoshin kot mendimtarët evropianë, që kanë ndërtuar filozofinë e shtetit e të demokracisë: populli është forcë pa sy, kurse zgjedhjet mund të jenë edhe akt joracional, - thashë.

## 26.8.1999

U takova, në Institutin Albanologjik, me dy anëtarë të Bundestagut (të Kuvendit) gjerman, që shoqëroheshin prej dy zyrtarëve të Zyrës gjermane në Prishtinë.

Me mua ishte Hydajeti, Hydajet Hyseni.

Më bombarduan me pyetje. Pyetjebërëse shumë e zellshme ishte sidomos anëtarja e Bundestagut, një grua a vajzë, nuk ia dija statusin. E hajthme, por shumë gjallëruese. Më bëri, njëren pas tjetrës, këto pyetje:

- Si e mendoni zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës?  
Si qëndron puna e sigurisë sot në Kosovë?

A janë të mbrojtura pakicat kombëtare sot në Kosovë?

Çka mendoni për kantonizimin?

A mund të bashkëjtohet me serbët?

Shqiptarët e kanë zakon hakmarrjen, prandaj a do të mund të pajtohen me serbët?

Iu përgjigja shkurt, me nga një a dy fjali në të gjitha këto pyetje.

Shpresoj që zgjidhja përfundimtare e çështjes së Kosovës do të jetë kjo: një kohë Kosova do të jetë shtet i lirë e i pavarur dhe, mandej, me referendum, do të vendosë për bashkimin me Shqipërinë.

- Siguria në Kosovë sot nuk mund të quhet e qëndrueshme; duhet, prandaj, të punohet shumë për t'ua siguruar jetën njerëzve, e të gjithëve, dhe për të siguruar vetë Kosovën.

- Pakicat kombëtare në Kosovë mund të jenë më të mbrojtura se ç'janë sot. Pjesëtarët e të gjitha këtyre pakicave, duke përfshirë edhe serbët, që s'kanë bërë krime, janë qytetarë të Kosovës dhe duhet të sigurohen të gjitha të drejtat e tyre, siç u sigurohen pakicave edhe në Gjermani.

- Kantonizimi do të përfaqësonte rrezik për Kosovën dhe për rajonin dhe për këtë arsye kjo ide duhet të flaket njëherë e përgjithmonë.

- Serbët, që gjatë, me shekuj, ishin pakicë në Kosovë dhe shqiptarët, që gjithmonë ishin shumicë në Kosovë, dikur kanë bashkëjetuar pa i shkaktuar vuajtje njëri-tjetrit. Shqiptarët mund të bashkëjetojnë me serbët e Kosovës, natyrisht me serbët që nuk kanë bërë krime gjatë luftës.

- Janë pajtuar gjermanët dhe francezët, prandaj mendoj se mund të pajtohen dhe shqiptarët e serbët, por duhet të kalojë një kohë para këtij pajtimi, një kohë gjatë së cilës do të shpjegohen e do të sqarohen gjithë ato që kanë ndodhur në Kosovë nën regjimin e dhunës e të terrorit të Slllobodan Millosheviqit. Pajtimi i sigurt ndërtohet në themele të sigurta.

Në të njëjtat pyetje u përgjigj edhe Hydajeti duke shtuar të dhëna të reja e duke bërë shpjegime të reja.

## **27.8.1999**

Unë dhe Hydajet Hyseni u takuam me ish-ambasadorin britanik në Beograd, Brajan Donelli. Jam takuar shumë herë me të: dhe jam takuar para luftës këtu, në Prishtinë dhe, gjatë luftës,

në Tiranë. Marrëdhëniet e mia me të janë më tepër se zyrtare: janë marrëdhënie të bazuara në konsiderata të veçanta për njëri-tjetrin.

Biseduam afër një orë e gjysmë.

Më mbeti në kujtesë një mendim i tij, shumë i veçantë, shumë origjinal, që nuk e kisha dëgjuar prej asnjë diplomati a politikani me të cilët jam takuar deri tani:

- Në përpjekjet për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës do të jetë e pashmangshme të kalohen disa pragje.

Mençur e thënë.

Bukur e thënë.

Po nuk e pyetëm cilat janë ato pragje. S'deshëm ta sikletosnim.

Në fund të takimit ia dhurova një palë çorapë -punëdore nga gratë e Kosovës.

I erdhi shumë mirë.

Mbas takimit me ambasadorin Brajan Donelli, unë e Hydajeti u takuam me dy gazetarë: njëri gazetar japonez i gazetës *Asai Shimbun*, kurse tjetri, kolegu i tij, gazetar bullgar, korrespondent evropian i asaj gazete japoneze.

Biseduam për situatën politike në Kosovë, për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës, për demokratizimin e Kosovës, për mundësitë e bashkëjetesës në Kosovë, për sigurinë në Kosovë.

Lapsat e tyre kimikë, çfarë nuk kisha para ndonjëherë në duart e të huajve, me të cilët isha takuar, i qitnin shkronjat në letër shumë qartë: fytëzat e tyre sigurisht ishin kimikisht shumë cilësore.

Më vonë erdh një amerikan - nëpunës i Ambasadës amerikane në Shkup, që m'i mori disa shënime jetëshkrimore dhe pasaportën për të më nxjerrë vizën me të cilën do të shkoj në seminarin për demokracinë, që do të mbahet në Uashington. Ma dha ta shikoj listën e të ftuarve në atë seminar. Ishin ftuar kush duhet e kush s'duhet, kush ka gojë e kush ka vetëm veshë!

Ditë boshe, e tepërt në jetën time. S'do të kujtohet as me diell, as me vranësirë!

## 28.8.1999

Nuk dola fare prej shtëpisë.

Deri në orën 12:00 pata disa mysafirë: bashkëpunëtorë dhe miq.

Pak lexova.

Pak lypa sende të humbura në bibliotekë.

Pak brodha poshtë e lart nëpër shtëpi.

Pak shikova televizor.

Pak bisedova me Shpresën, që ishte e zënë me përgatitjen e drekës.

Shumë bisedova me Valjetin dhe me Donikun.

Humorin e kam të plagosur, ndoshta pse kam dhembje të forta në kryqe e, ndoshta, edhe pse nuk po arrij të punoj sa duhet e si duhet me laps. Po e mbaj këtë ditar cilësisht jo siç e kam mbajtur viteve të shkuara.

Në humorin tim të plagosur sigurisht kontribuojnë edhe problemet e shumta të jetës sonë të përditshme në krejt Kosovën: kriminalizimi i rrufeshëm i jetës, i ekonomisë dhe i mikrotregtisë, që mund të jetë qëllimisht i lejuar, prandaj edhe i heshtur prej UNMIK-ut, korrupsioni gjithnjë e më i përshtirë, mashtrimet, gënjeshttrat dhe shpifjet, që mbizotërojnë çdo bisedë zyrtare dhe private! E të tjera.

Jeta jonë po bëhet gjithnjë e më e ndotur. Dhe shumë shpejt!

E jeta e ndotur nuk është jetë.

## 29.8.1999

As sot s'dola prej shtëpisë.

Dëgjova lajme në Dojçe Vele, në Zërin e Amerikës, në Evropën e Lirë.

Gazeta ende nuk lexoj sepse ende vazhdoj të jem i neveritur prej tyre. Gjatë viteve të shkuara, duke lexuar shumë gazeta jam

dëshpëruar tepër me disa gazetarë. Me përjashtim të disave prej tyre, shumica janë në shumë pikëpamje gjysmakë: përgjysmë të shkolluar, përgjysmë të edukuar, përgjysmë të kulturuar, përgjysmë të moralshëm. Gjysmakja e përgjithshme i bën përgjithësisht të padëshiruar për gazetari dhe të papranuar për bashkëbisedim. Gënjeshttrat, mashtrimet, intrigat, denoncimet sikur janë bërë pjesë e profesionit të tyre.

Në dreq të mallkuar!

Pak pa u bërë mesnata e mbarova leximin e librit të publicistit dhe mendimtarit të shquar francez Lafor, *Demokracia dhe totalitarizmi*. Prej kësaj vepre mund të mësohet shumë për demokracinë dhe për totalitarizmin sikur të mos kishte aq shumë formulime të paqarta, në të vërtetë aq shumë, si të them, paqartësi qëllimore dhe aq shumë, si të them, perversione mendore! Më shumë se vetë autori, këtyre paqartësive u ka kontribuar edhe përkthyesi. Përkthimi i librit *Demokracia dhe totalitarizmi*, që është një lekturë tepër e rëndësishme sidomos për lexuesit e vendeve ish-komuniste, është me të vërtetë shumë i dobët. Mjerisht.

### 30.8.1999

E hënë.

Vapa e gushtit po zëvendësohet prej ngrohtësisë së këndshme të shtatorit, që fillon pasnesër.

Me Hydajetin u takuam me senatorin amerikan që s'ia mbaj mend emrin, në zyrën e LBD-së. Erdhi pak para kohës, por, megjithatë, s'na gjet në zyrë!

Ishte i moshuar. Lëvizjet e buta, fjalët e ngadalta, zëri i ulët e tregonin njeri shumë të qetë. Përplot skrupuj. Është e vështirë të dihet nëse do të jetë rritur në qytet apo në fermë.

Na bëri një varg pyetjesh që, zakonisht po na i bëjnë edhe të tjerët mbas çlirimit të Kosovës prej pushtimit serb: për situatën



aktuale, për të ardhmen e Kosovës, për trajtimin e pakicave, për marrëdhëniet e partive politike shqiptare mes vete dhe me administratën ndërkombëtare. Por, na bëri edhe disa pyetje të pazakonshme, që s'na i kishin bërë të tjerët.

Kështu, fjala vjen, më bëri pyetjet:

- A keni drojë prej kalimit të krimit të organizuar prej Shqipërisë në Kosovë?

A jam i informuar për qarkullimin e drogës në Kosovë?

Çfarë feje kam? Islame?

A u përmbahem rriteve fetare?

Më befasoi me këto katër pyetje.

I thashë se krimi në Kosovë dukshëm më pak do të importohet prej Shqipërisë a Maqedonisë e dukshëm më shumë do të prodhohet në Kosovë dhe, sidomos, në pjesën Veriore të Kosovës. Krimin edhe në Kosovë, si në të gjitha vendet ballkanike, sidomos ish-komuniste, e nxisin varfëria, korrupsioni, prapambetja në zhvillimin ekonomik.

Prindërit e mi janë të fesë islame. Unë, i thashë, nuk i ushtroj ritet fetare. Ne shqiptarët jemi pjesëtarë të tri feve - katolike, ortodokse dhe myslimane dhe, ndoshta, për këtë arsye na shquan një mënjani (indiferencë) fetare. Normat etike i bazojmë më shumë në zakonet sesa në fenë: në zakonet me të cilat është rregulluar jeta jonë shoqërore me shekuj.

I thashë se në Kosovë nuk prodhohet drogë dhe tani për tani nuk duket farë qarkullimi më shqetësues i lëndëve narkotike në Kosovë.

I thashë se situata e përtashme karakterizohet me përpjekje të administratës ndërkombëtare dhe të neve, shqiptarëve, për ndërtimin e institucioneve politike e qeverisëse.

I thashë se besojmë se Kosova do të bëhet shtet i lirë e i pavarur që, mbas një kohe, me referendum, do të bashkohet me Shqipërinë.

I thashë se të gjithë pjesëtarët e të gjitha pakicave kombëtare, duke përfshirë këtu edhe serbët, janë qytetarë të Kosovës dhe

duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat që gëzojnë gjithë qytetarët e tjerë të Kosovës.

I thashë se marrëdhëniet mes partive politike shqiptare janë marrëdhënie njëherë për njëherë të karakterizuara prej përpjekjesh për shquarjen e identitetit partiak dhe për prestigj në popull.

I thashë se marrëdhëniet e partive tona politike me administratën ndërkombëtare janë shumë të mira dhe janë ashtu si duan faktorët ndërkombëtarë.

I thashë disa fjalë për fundamentalizmin mitologjik serb për Kosovën dhe për idenë e kantonizimit të Kosovës si një ide që përfaqëson rrezik për Kosovën dhe rajonin.

Meqenëse senatori amerikan mbas fjalës sime donte të dinte se ku jam shkolluar dhe me çka merrem, Hydajeti ia tha disa fjalë për Lëvizjen e Bashkuar Demokratike dhe disa fjalë për mua. I tha se jam shkrimtar e studiues shkencor, autor i shumë veprave.

Mbasi i dëgjoi fjalët e Hydajetit, senatori amerikan tha:

- Unë s'e kam shkruar asnjë vepër; e kam kaluar jetën me punë politike.

- Ju nuk keni shkruar vepra letrare a shkencore, por me veprimtarinë tuaj politike u keni ndihmuar njerëzve shumë më tepër se unë dhe se ç'do t'u ndihmonit me vepra letrare a shkencore, - iu përgjigja.

Duke e përcjellë ia thashë disa fjalë për punën e Institutit Albanologjik. Kur e shtriu dorën të lamtumiremi më tha:

- Në Nju-Jork çdo vit organizojmë një mëngjes për shumë njerëz dhe ky mëngjes organizohet në kujtim të Jezu Krishtit dhe mbi parimet e mësimit të tij. A do të pranoni të merrni pjesë në të? - më pyeti.

- Po, me shumë dëshirë, - iu përgjigja.

U përshëndetëm me shumë përzemërsi.

Në orën 13:00, unë, Mehmeti dhe Hydajeti shkuam në takim me Riçard Hollbrukun në zyrën amerikane. Megjithëse u vonuam dhjetë minuta, u desh ta presim edhe dhjetë minuta: ai kishte qenë në Komandën e KFOR-it.

U përshëndet me ne përzemërsisht, kurse mua më përqafoi shqiptarçe. Isha takuar me të njëherë, në verën e vitit 1998, kurse herën tjetër, nuk kishte ardhur në takimin e caktuar, por kishte çuar ambasadorin Kristofer Hill.

Derisa ishte ende në këmbë Hollbruku na uroi lirinë.

Pastaj u ul në kanape.

- Do të dëshiroja, - tha, - ta di mendimin tuaj për situatën politike në Kosovë.

Para se t'i përgjigjesha, e urova për emërimin ambasadori SHBA-së në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Njëkohësisht shfrytëzova rastin të falënderoj SHBA-në për krejt ç'kanë bërë në Kosovë dhe për Kosovën. Dhe para tij e zbraza batarenë gojore për mbrojtjen e vlerave të qytetërimit në Kosovë nga NATO-ja në krye me SHBA-në. Pastaj i fola për situatën politike në Kosovë.

- Sot në Kosovë po jetohet pothuaj normalisht dhe, ç'është me rëndësi të veçantë, po jetohet me besim në të ardhmen. Por, kjo nuk do të thotë se nuk ka probleme, nuk paraqiten ide e kërkesa dhe s'bëhen kur e kur edhe disa veprime shqetësuese.

Kështu, fjala vjen, kërkesa për krijimin e kantoneve serbe në Kosovë është një kërkesë e rrezikshme për Kosovën dhe për rajonin.

- Të mos humbim fare kohë për atë çështje! Nuk lejojmë që të bëhet, - tha Hollbruku.

Mandej pyeti për zgjedhjet e ardhshme.

- Kur mendoni se është më së miri të mbahen?

- Në qoftë se duam të përgatiten mirë, mirë në të gjitha pikëpamjet, besoj se nuk duhet të mbahen para një viti e gjysmë.

- Si e shihni të ardhmen e Kosovës? - pyeti.

E shoh shtet të lirë, të pavarur, të njohur prej numrit më të madh të shteteve në botë. Mbas një kohe, nuk mund ta di mbas sa vjetësh, e shoh të bashkuar me Shqipërinë dhe të bashkuar në sajë të referendumit në të cilin do të pyetej populli: nëse Kosova duhet të bashkohet me Shqipërinë apo duhet të vazhdojë si shtet i lirë e i pavarur.

Mandej pyeti:

- Çka mendoni për pakicat, në mënyrë të veçantë për pakicën serbe?

Pjesëtarët e pakicave janë qytetarë të Kosovës dhe duhet të jenë të barabartë me popullin shumicë, me shqiptarët, në të gjitha pikëpamjet. E kemi provuar vetë gjatë dhe vrazhdë diskriminimin dhe nuk duhet të lejojmë asnjë çast të diskriminohet kush në Kosovën e lirë, të pavarur e demokratike.

- Si i shihni marrëdhëniet me Shqipërinë? - pyeti mandej Hollbruku.

- Marrëdhëniet e Kosovës me Shqipërinë nuk mund të jenë si marrëdhëniet me shtetet e tjera në Ballkan, në Evropë a kudo qoftë tjetër. Meqenëse shqiptarët e Shqipërisë dhe shqiptarët e Kosovës janë një popull me gjuhë të njëjtë, të përbashkët, me histori të përbashkët, me kulturë e qytetërim të përbashkët, me zakone të përbashkëta, me mentalitet të njëjtë, është e kuptueshme që Kosova dhe Shqipëria të kenë marrëdhënie jomiqësore po vëllazërore.

- A shihni rrezik prej korrupsionit? - pyeti Hollbruku.

- Korrupsioni është dukuri që godet rrënueshëm demokracinë, që godet rrënueshëm ekonominë, që çmoralizon shtetin dhe shoqërinë. Duhet, prandaj, të luftohet me të gjitha mjetet ligjore.

Mandej pyeti:

- A do të shkoni në mbledhjen e Parlamentit të Kosovës që mbahet shpejt?

- As Lëvizja e Bashkuar Demokratike, si lëvizje, e as unë, nuk do të shkojmë në atë mbledhje, iu përgjigja. Mendoj se diplomatët dhe pjesëtarët e administratës ndërkombëtare në Kosovë, që do të shkonin në atë mbledhje, do të duhej ta dinin se ashtu i frymëzojnë, i nxisin ndasitë brendashqiptare. Ai është quajtur Parlament i Republikës së Kosovës, që fjalën republikë e ka shfrytëzuar për të mashtruar popullin, për të mbledhur para prej tij, një pjesë e të cilave ka përfunduar në xhepa të individëve të LDK-së, kurse një pjesë tjetër sot përdoren për vetë LDK-në dhe për satelitët e saj partiakë! Ai parlament ishte shpikje e një politike naive dhe